



RAPORT VJETOR 2015





RAPORT VJETOR 2015

PËRMBAJTJA

10 PROGRAMI: **DEMOKRATIZIMI DHE PRAKTIKAT PARLAMENTARE (DPP)**

12 Le të komunikojmë
me njëri-tjetrin në vend
se për njëri-tjetrin.

15 Mbështetje për Hulumtime
Parlamentare dhe Pjesëmarrje
Qytetare në Politikëbërje

18 PROGRAMI: **TRANSPARENCA DHE KUNDËR KORRUPSIONI (TKK)**

20 Rritja e efikasitetit dhe transparencës
së sistemit të prokurimit publik dhe
reduktimi i korrupsionit nëpërmjet
monitorimit aktiv

24 Forcimi i sistemeve ndërkombëtare të
integritetit në Ballkanin perëndimor
dhe në Turqi

27 Qendra për avokim dhe këshilla
ligjore (ALAC)

44 PROGRAMI: QEVERISJA LOKALE DHE PJESËMARRJA QYTETARE (QLPQ)

45 Transparenca Institucionale në Nivel
Qendror dhe Lokal

46 Përmirësimi i transparencës
komunale

49 Përfshirja qytetare për transparencë
dhe llogaridhënie

51 Përkrahje për Procesin e reformës së
Administratës Publike duke përmirësuar
menaxhimin financiar dhe kontrollin

53 Demos -
Demokracia Lokale

34 PROGRAMI: ZGJEDHJET E LIRA DHE TË DREJTA (ZLD))

37 Mbështetje për
monitorim të zgjedhjeve
vendore

42 Personat me aftësi të
kufizuar monitorojnë
të drejtat e tyre
për qasje

54 KDI NË INICIATIVA TË
PËRBASHKËTA ME OSHC

56 INFOGRAFIKAT

59 STRUKTURA
ORGANIZATIVE E KDI

62 QEVERISJA E
BRENDSHME E KDI

63 DONATORËT

64 PASQYRAT
FINANCIARE

MISIONI

Misioni i KDI është të mbështesë zhvillimin e demokracisë duke fuqizuar qytetarët dhe sektorin joqeveritar për të ndikuar në rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së institucioneve qeveritare dhe përmirësimin të efikasitetit të këtyre institucioneve përmes pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje.

VIZIONI

KDI synon të jetë një organizatë rajonale me ndikim në proceset politike përmes ofrimit të asistencës në procesin e demokratizimit.

HYRJE

Në vitin e tij jubilar, 10 vjet nga themelimi, Instituti Demokratik i Kosovës ka vazhduar të mbështesë zhvillimin e demokracisë duke qenë kërkues dhe aktiv në promovimin e transparencës, llogaridhënies dhe integritetit institucional karshi qytetarëve si dhe duke promovuar pjesëmarrjen qytetare në politikëbërje dhe vendimmarrje.

KDI ka vlerësuar 2015-tën si një vit sfidues për vendin dhe ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të dhënë kontributin e saj në fuqizimin e shoqërisë civile dhe mbajtjen e institucioneve sa më përfaqësuese, llogaridhënëse dhe transparente. Të gjitha gjetjet KDI i ka vënë në dispozicion të qytetarëve dhe publikut, ndërsa ekspertizën dhe aktivitetin e saj avokues e ka bërë përmes publikimeve, analizave, debateve, takimeve, monitorimit të institucioneve dhe ofrimit të konsultave për qytetarët. KDI poashtu ka qenë aktive në mobilizimin dhe ofrimin e ekspertizës dhe përvojës profesionale të saj dhe OSHC-ve tjera për të garantuar vendim-marrje dhe politika publike më gjithpërfshirëse.

Këtë 10-vjetor jubilar, KDI e shënon duke qenë pjesë e lëvizjeve globale për një botë më të mirë. Në janar të këtij viti, KDI-ja, zyrtarisht u bë “Chapter” i “Transparency International”, teksa në shkurt anëtare e rrjetit të OJQ-ve për monitorimin e zgjedhjeve, ENEMO.

Të gjitha këto ndërmarrje nuk do të ishin bërë të mundura pa përkushtimin e stafit të saj dhe mbështetjen e qytetarëve, donatorëve e partnerëve për të cilët KDI është jashtëzakonisht falenderuese.

KDI do të vazhdojë të punojë me këmbëngulësi drejt përbushjes së misionit dhe vizionit të saj për një shtet demokratik, të përgjegjshëm dhe të lirë nga korrupsioni, që garanton mirëqenie, dinjitet dhe prosperitet për qytetarët e saj.

MIRËSEVINI NË UDHËTIMIN TONË

Outputet dhe Statistikat

- 01 Uebplatforma Votalme (1)
– mesatarisht 100 vizita në ditë
- 02 Databaza e OJQ-ve dhe hulumtuesve (1)
– 80 OJQ/institute hulumtuese
- 03 Gara për Foton më të mirë (1)
– 130 fotografi
- 04 Publikime/Analiza (16)
- 05 Hulumtime Parlamentare (20)
- 06 Tryeza (35)
– 475 pjesëmarrës
- 07 Dëgjime Publike (16)
– 213 pjesëmarrës
- 08 Konferenca për media (25)
- 09 Komunikata për media (47)
- 10 Debate Televizive (8)
- 11 Sesione/takime informuese me qytetarë (52)
- 12 Editoriale (11)
- 13 Trajnime (9) – 204 pjesëmarrës
- 14 Artikuj në media (211)
- 15 Seanca/mbledhje të monitoruara (274)
- 16 Konsulta ligjore për viktimat e korrupsionit (35)
- 17 Manuale (1)
- 18 Infografika (15)
- 19 Procese zgjedhore të monitoruara (3)
– 37 vëzhgues
- 20 Grupe Fokusi (7)
– 64 pjesëmarrës
- 21 Punëtori (10)
- 22 Vizita në terren me shtande (8)
- 23 Broshura (900)
- 24 Buletine dy-mujore (5)

ARRITJET DHE REZULTATET E PËRGJITHSHME

- KDI/Demokracia në Veprim **anëtarësohet** në Rrjetin Evropian të Organizatave për Monitorim të Zgjedhjeve, ENEMO dhe pas kësaj merr pjesë në kontigjentin e vëzhguesve ndërkombëtarë të ENEMO-së për monitorimin e zgjedhjeve lokale në Ukrainë
- **Tre palë zgjedhje** të monitoruara, dhjetë (10) vëzhgues të DnV të certifikuar si vëzhgues afatshkurtër (STO) nga OSBE/ODIHR
- Lansimi i ueb-platformës Votaime.org shënon një kthesë në kuptimin e shfrytëzimit të teknologjisë informative për avancim të demokracisë dhe po ndikon që **publiku të jetë më i informuar** për punën e Kuvendit dhe u ka shërbyer mediave si burim objektiv për artikujt e tyre
- Shpenzimet dhe **udhëtimet e deputetëve** për herë të parë janë bërë publike e deputetët e Kuvendit u referohen të dhënave të Votaime gjatë diskutimeve të tyre
- Deputetët janë **më të përgjegjshëm** në adresimin e pyetjeve që vijnë nga qytetarët
- Hulumtimet parlamentare që KDI ofon për Komisionet në bazë të kërkesave të tyre **po shfrytëzohen** nga anëtarët e komisioneve dhe inputet që dalin nga to, po përfshihen në procesin e draftimit të ligjeve.
- Është **ngritur interesimi i Komisioneve Parlamentare** për të kërkuar hulumtime parlamentare nga jashtë dhe poashtu është rritur kërkesa për hulumtime të brendshme në Departamentin për Hulumtime në Kuvendin e Kosovës
- Aplikimi i prokurimit të centralizuar, respektivisht kontrata kornizë e monitoruar për blerjen e derivateve tregoi për kursime në buxhetin e Kosovës në vlerë mbi **700,000 Euro**.
- Është bërë skenimi i përgjithshëm i sistemit dhe integritetit institucional, një studim voluminoz i përcjellur nga rekomandimet specifike për secilin nga 15 sektorët ose institucionet vitale të shtetit

365 DITOR TË DEMOKRACISË!



Donatorët

- **Nuk ka kaluar Projekt-ligji për parandalimin e konfliktit** e interesit vetëm me ndryshime kozmetike të propozuara nga Qeveria. KDI dhe Çohu! kanë kërkuar ndryshime thelbsore në ligj, përfshirë përcaktimin e qartë të kategorive të zyrtarëve publikë dhe masat në parandalimin dhe sanksionimin e konfliktit të interesit

- Me insistimin e KDI, Çohu dhe FOL, **Neni 437 i Kodit Penal** do të vazhdojë që të sanksionojë penalisht zyrtarët që nuk deklarojnë apo deklarojnë rrejshëm pasurinë e tyre. OSHC-të kanë dënuar mundësinë e mosdënimit të zyrtarëve publik për deklarimin e rrejshëm të pasurisë së tyre dhe e kanë vlerësuar këtë gjë vepër penale.

- Si rezultat I raportimit të rasteve të dyshuara për korrupsion, kurdisje tenderi dhe favorizim në Qendrën e KDI-së për Avokim dhe Këshilla Ligjore dhe pas interesimit të KDI për të mësuar më shumë, **janë anuluar dhe vendosur nën hetime** tre tenderë në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe një tender në Ministrinë e Administratës Publike

- Për herë të parë **në botë**, KDI/DnV angazhon **mbi 200 vëzhgues afatgjatë me aftësi të kufizuara** për të monitoruar procesin zgjedhor. Si rezultat i projektit për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në procese zgjedhore u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit midis KQZ dhe OSHC-ve që merren me aftësinë e kufizuar, e që mundëson angazhimin e personave me aftësi të kufizuara në pozita të ndryshme si staf zgjedhor.

- MAPL **ka adoptuar dhe institucionalizuar 90%** të indikatorëve që KDI shfrytëzon për matjen e transparencës (Transparometrin) në komuna. Kjo metodologji do t'i shërbejë MAPL-së për matjen e transparencës në të gjitha komunat e Kosovës në 2016.

- Si rezultat i publikimit të Fletënotimit vjetor në nivel komunal, është rritur **dinamika e diskutimeve** në Kuvendet komunale, është përmirësuar performanca e institucioneve në aspekt të ofrimit të qasjes në informata publike dhe bërjen publike të shpezimeve.

- Për herë të parë, me mbështetjen e KDI, Grupi i Grave Asambliste në Prizren është involvuar në procesin zgjedhor të këshillave lokale duke e mbështetur dhe fuqizuar kështu gruan në vendim-marrje. Për herë të parë **një grua është zgjedhur kryetare e këshillit lokal**, ndërsa dy tjera anëtare të këshillave lokale.

- Ambasada Britanike
- Ambasada Gjermane
- GFA Consulting Group
- Helvetas
- IFES
- KCSF

- KFOS
- Komisioni Evropian
- Olof Palme International Center
- UNDP
- USAID

Bordi

- 01 Bashkim Gashi
- 02 Enver Robelli
- 03 Jehona Lushaku
- 04 Rreze Duli
- 05 Violeta Zeka

Stafi

- 01 Albert Krasniqi
- 02 Arben Hoxha
- 03 Artan Canhasi
- 04 Bora Duli
- 05 Diana Metushi-Krasniqi
- 06 Driton Selmanaj
- 07 Edita Mustafa-Salihi
- 08 Festina Kabashi
- 09 Fiona Mustafa
- 10 Fjolla Uka
- 11 Florent Spahija
- 12 Genc Jaha
- 13 Ismet Kryeziu
- 14 Isuf Zejna
- 15 Jetmir Bakija
- 16 Kaltrina Ahmeti
- 17 Leonora Cikaj
- 18 Majlinda Kurti
- 19 Mërgime Kajtazi
- 20 Musa Bajraktari
- 21 Naim Cahanaj
- 22 Nita Tafarshiku
- 23 Qëndresa Mrasori
- 24 Visar Sutaj
- 25 Vjollca Vogel



PROGRAMI:
DEMOKRATIZIMI
DHE PRAKTIKAT
PARLAMENTARE
(DPP)



▼ Statistikat e përgjithshme të programit:

Viti 2015 ka shënuar një vit jashtëzakonisht të vështirë për historinë e Kuvendit që nga themelimi i tij. Kundërshtimet e mëdha politike ndërmjet partive në pushtet dhe atyre në opozitë rezultuan me krizën më të madhe politike në vend. Kundërshtimi i marrëveshjes për krijimin e Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe dhe Marrëveshjes për demarkacionin me Malin e Zi, kanë qenë pikat kulmore të këtyre përplasjeve. Bllokimi i seancave plenare, përdorimi i gazit lotsjellës, zhvillimi i seancave plenare në salla të improvizuara, shkeljet e procedurave dhe praktikave parlamentare, miratimi i ligjeve pa debat të mirëfilltë parlamentar, përjashtimi kolektiv i deputetëve të opozitës, arrestimet e deputetëve janë disa nga emëruesit e përbashkët që kanë përcjellë Kuvendin përgjatë vitit 2015.

Kriza politike që ka afektuar Kuvendin dhe bojkotimi i komisioneve nga subjektet opozitare pashmangshmërisht ka ndikuar edhe në rezultatet e projekteve të KDI-së të lidhura me Kuvendin. Sidoqoftë, programi për demokratizim dhe praktika parlamentare në 2015-tën ka ardhur në shprehje edhe më fuqishëm, sidomos pas lansimit të ueb-platfomës interaktive Votaime.org. KDI ka vazhduar monitorimin e punës së Kuvendit të Kosovës dhe trupave të saj si dhe fashilitimin e ekspertizës së jashtme për komisionet parlamentare, përkatësisht ngritjen e kapaciteteve të Departmentit për Hulumtime në Kuvend. Përmes këtyre dy projekteve që janë zbatuar në 2015, KDI është përpjekur të bëjë publike punën e Kuvendit, të mbajë atë më të përgjegjshëm dhe llogaridhënës, t'i kontribuojë punës së komisioneve me hulumtime dhe ekspertizë për të nxjerrë legjislacion më kualitativ dhe të implementueshëm dhe të inkurajojë vendim-marrje më gjithpërfshirëse.

Kontributi i DPP për reformat dhe demokratizimin e Kuvendit bëhet përmes raporteve periodike të vlerësimit, përgatitjes së analizave të politikave, takimeve të drejtpërdrejta me zyrtarë të zgjedhur dhe qeveritar, organizimit të tryezave për përballje mes qytetarëve dhe zyrtarëve të zgjedhur në nivele të ndryshme, vlerësimit të performancës individuale të deputetëve, grupeve parlamentare dhe Kuvendit si institucion.

1	Uebplatformë Votaime.org
1	Databazë e OJQ-ve dhe hulumtuesve (80)
6	Konferenca për shtyp
8	Komunikata për shtyp
20	Hulumtime parlamentare
6	Tryeza
5	Dëgjime publike
60	Artikuj ne media
3	Infografika
200	Seanca të Kuvendit, Kryesisë dhe Komisioneve parlamentare
6	Editoriale
3	Debate Televizive



1.1 LE TË KOMUNIKOJMË ME NJËRI-TJETRIN NË VEND SE PËR NJËRI-TJETRIN

Platforma interaktive e bazuar në ueb, “www.votaime.org” të cilën KDI e lansoi në vjeshtë të 2015-tës, shënon një kthesë në kuptimin e shfrytëzimit të teknologjisë informative për avancim të demokracisë. Kjo platformë e dizajnuar edhe në verzionin mobil ka për qëllim të instalimit

të një praktike të re të komunikimit ndërmjet qytetarëve dhe deputetëve, të ndikojë në ngritjen e zërit dhe hapësirës më të madhe për aktivizëm qytetar, të avancojë llogaridhënien parlamentare, të rrisë përfaqësimin dhe transparencën, si dhe të përfshijë qytetarët në vendim-marrjepërmes shfrytëzimit të teknologjisë informative. Platforma ushqehet nga të dhënat që merren nga monitorimi aktiv dhe i rregullt i seancave plenare të Kuvendit dhe Kryesisë, përcjellja e takimeve të 14 komisioneve të përhershme dhe funksionale, si dhe aktivitetet zyrtare të 120 deputetëve të zgjedhur. Të dhënat përpunohen në kohë reale, ndërsa mundësitë e krahasimit të të dhënave janë të panumërta.

The screenshot displays the VOTAIME web application interface. At the top, there is a navigation bar with the logo 'VOTAIME' and menu items: 'A E DINI SE?', 'PËR PROJEKTIN', 'PUBLIKIMET', 'KONTAKTI', and 'NA SRPSKI'. Below this is a secondary navigation bar with icons for 'KUVENDI', 'DEPUTETET', 'LIGJET', 'SEANCAT', 'KOMISIONET PARLAMENTARE', 'PYET DEPUTETIN', 'UDHËTIMET E DEPUTETËVE', and 'SHPENZIMET E KUVENDIT'. The main content area is titled 'PYET DEPUTETIN' and includes a brief explanation of the mandate and a call to action. A prominent donut chart shows '56%' completion, with the text '10 përgjigje nga 18 pyetje gjithsej'. Below the chart are two buttons: 'Përgjigjet e deputetëve' and 'Përgjigjet sipas partisë'. The bottom section, 'LISTA E DEPUTETËVE', features a search bar, a filter dropdown, and sorting options for 'EMRI DHE MBIEMRI', 'PJESËMARRJA NË SEANCA PLENARE', 'PËRGJIGJET NË PYETJET E QYTETARËVE', and 'LOJALITETI NDAJ GRUPIT PARLAMENTAR'. A specific entry for 'Abdyl Ymeri' from the 'PDK/PD/LB/PSHDK/PK' party is shown with a 91% response rate and a 0% loyalty rate.




ARRITJET E PROJEKTIT

- Vota ime po ndikon që publiku të jetë më i informuar për punën e Kuvendit. Mesatarisht janë rreth 100 vizitorë ne ditë
- Shpenzimet dhe udhëtimet e deputetëve për herë të parë janë bërë publike
- Deputetët e Kuvendit i referohen të dhënave të platformës në kohën për pyetje parlamentare
- 16 pyetje janë ngritur nga qytetarët drejtpërdrejtë në platformë, deputetët u janë përgjigjur 10 pyetjeve
- Mediat kanë ndërtuar kronika, storie etj duke shfrytëzuar platformën si burim objektiv për artikujt e tyre
- Kuvendi është në dizajnim të një platforme të ngjashme, ka kërkuar ndihmë nga KDI
- Publikimi dhe kategorizimi i pyetjeve të deputetëve drejtuar ministrave ka ndihmuar në profilizimin e deputetëve në bazë të sektorëve ku janë më aktiv.



Statistikat e projektit:

- | | |
|-----------------------------------|--|
| 1 Uebplatformë Votaimë.org | 3 Infografika |
| 6 Konferenca për Media | 200 Seanca të Kuvendit, Kryesisë dhe Komisioneve parlamentare |
| 8 Komunikata për Media | 6 Editoriale |
| 60 Artikuj ne media | 3 Debate Televizive |





1.2 MBËSHTETJE PËR HULUMTIME PARLAMENTARE DHE PJESËMARRJE QYTETARE NË POLITIKËBËRJE

Përkundër dinamikës së ulët të Kuvendit dhe përmbushjes së zbehtë të agjendës legjislative më 2015, KDI ka bërë përpjekje maksimale të jetë në shërbim të komisioneve parlamentare, duke ofruar ekspertizë të jashtme në funksion të ndërtimit të legjislacionit me kualitativ dhe praktikisht më të implementueshëm. Viti 2015 shënon një rritje substanciale të kërkesave për hulumtime nga deputetët dhe 14 komisionet parlamentare. Kjo mund të përkthehet me rëndësinë dhe vlerën që ato po japin në prodhimin e legjislacionit më kualitativ dhe të bazuar në ekspertizë të jashtme (OSHC dhe hulumtues të pavarur). Të gjitha kërkesat për hulumtime fillimisht janë kanalizuar përmes Drejtorisë për Hulumtime, Bibliotekë dhe Arkivë (DHBA) në kuadër të Kuvendit. KDI ka mbështetur edhe këtë zyrë me ngritje të kapaciteteve.

KDI ka punuar ngushtë me DHBA-në për të përzgjedhur temat dhe hulumtuesit më adekuatë për të angazhuar kapacitetet hulumtuese jashtë administratës së Kuvendit. Në funksion të kësaj, KDI në tetor 2015 ka organizuar një tryezë për të vlerësuar të arriturat dhe sfidat që kanë përcjellur punën gjatë vitit të parë dhe për të promovuar tek ligjvënësit që t'a shfrytëzojnë këtë mundësi sa më shumë dhe në funksion të miratimit të ligjeve më cilësore. Duke pasë si synim shkëmbimin e pëvojave të mira dhe ofrimin e ekspertizës cilësore komisioneve parlamentare, KDI në shtator 2015 ka mbledhur bashkë në një punëtori një ditore disa hulumtues të jashtëm të kontraktuar nga KDI dhe hulumtues të Departmentit për Hulumtime, Bibliotekë dhe Arkivë (DHBA) për të shkëmbyer përvojat dhe metodologjitë e tyre në hulumtime legjislative. Hulumtuesit e DHBA-së u njohtuan edhe për mënyrat e prezantimit të të dhënave, burimet e shfrytëzuara, etj.

Si sukses më i lartë i këtij projekti mbetet lansimi dhe promovimi i databazës online, me qëllim të bashkimit të instituteve lokale të hulumtimit dhe hulumtuesve të pavarur, përmes seancave informative në tërë Kosovën. Entuziazmi i deputetëve për shfrytëzimin e këtyre hulumtimeve të jashtme mbi temat e interesave të tyre poashtu nuk ka munguar. Hulumtuesit lokal poashtu kanë shprehur interesim për t'u angazhuar në ofrimin e hulumtimeve në Parlament, për të mirën publike.

Statistikat e projektit:

- 1 Databazë e OJQ-ve, institucioneve hulumtuese dhe hulumtues të pavarur (80 OJQ, hulumtues)
- 20 Hulumtime parlamentare nga OSHC-të dhe hulumtuesit individual
- 6 Tryeza (66 Pjesëmarrës)
- 5 Dëgjime Publike (132 pjesëmarrës)
- 2 Sesione informuese për OJQ
- 1 Punëtori





LISTA E HULUMTIMEVE PARLAMENTARE TË REALIZUARA NË 2015

1. Hulumtim mbi Taksat kufitare të automjeteve me targa të huaja që hyjnë në Kosovë, prill 2015
2. Hulumtim mbi Projektligjin për Ndryshim dhe Plotësim për Këshillin Prokurorial të Kosovës, maj 2015
3. Hulumtim mbi Projektligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, maj 2015
4. Hulumtim mbi Projektligjin për Armët, maj 2015
5. Hulumtim mbi Projektligjin për Letërnjoftime, maj 2015
6. Hulumtim mbi Projektligjin për Avokatin e Popullit, maj 2015
7. Hulumtim mbi Praktikat e Veprimtarisë Shëndetësore Private, qershor 2015
8. Hulumtim mbi Këshillin Ekonomik-Social, qershor 2015
9. Hulumtim mbi Financimin e Transmetuesit Publik, qershor 2015
10. Hulumtim mbi Praktikat për Ligjin për Kuvendin dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit, qershor 2015
11. Hulumtim mbi Ligjin për Administratën shtetërore, korrik 2015
12. Hulumtim mbi Ligjin për kufijtë administrative të komunave, qershor 2015
13. Hulumtim mbi Menaxhimin e Pyjeve, qershor 2015
14. Hulumtim mbi Ligjin për Lirinë e Asociimit në Organizata Jo Qeveritare, gusht 2015
15. Hulumtim mbi Rregullimin e Shëndetit Oral, tetor 2015
16. Hulumtim mbi të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, nëntor 2015
17. Hulumtim mbi Projektligjin për profesionet e rregulluara, dhjetor 2015
18. Hulumtim mbi Proekt-ligjin për kinematografinë
19. Hulumtimi mbi Projekt-ligjin për Kundërvajtje
20. Hulumtimi mbi Projekt-ligjin për Ushqimin





ARRITJET E PROJEKTIT

- Është ngritur interesimi i Komisioneve Parlamentare për të kërkuar hulumtime parlamentare nga jashtë dhe poashtu është rritur kërkesa për hulumtime të brendshme në DHBA
- Hulumtimet e ofruara nga KDI-ja, po trajtohen seriozisht nga anëtarët e komisioneve dhe inputet që dalin nga to, po përfshihen në procesin e draftimit të ligjeve.
- Janë krijuar mundësi të reja për përfshirjen e instituteve hulumtuese dhe ekspertëve individualë në një databazë, që me punimet e tyre hulumtuese, të bëhen pjesë e ligjbërjes



PROGRAMI:
TRANSPARENCA
DHE KUNDËR-
KORRUPSIONI
(TKK)

Raportet ndërkombëtare kanë vazhduar të vlerësojnë korrupsionin në sektorin publik e privat në Kosovë si endemik dhe si një problem mjaft serioz. Për këtë, ata pjesërisht fajësojnë impotencën e sistemit funksional juridik për të ndëshkuar personat e korruptuar. Programi i KDI-së për Transparencë dhe Korrupsion ka qëllim që të ndikojë në promovimin e një kulture kundër-korrupsion dhe në krijimin e një ambienti ku dominojnë institucionet me integritet të lartë e të cilat do të jenë në gjendje të ndërmarrin masa efikase për çrënjësosjen e praktikave korruptive, si në organizatat publike si dhe në ato private. Misioni kryesor i programit të Transparencës dhe Kundër-korrupsionit (TKK), si degë e lëvizjes globale kundër korrupsionit, Transparency International (TI), është që të angazhohet për krijimin e një ambient shoqëror, institucional e politik të lirë nga korrupsioni.


Indeksi Global i Përceptimit të Korrupsionit (CPI) për 2015, ka rradhitur Kosovën në vendin 103 me 33 pikë. Krahasuar me 2014 Kosova nuk ka shënuar ndonjë përparim krahasuar me dy vitet e fundit. Për dallim nga shtetet rajonit, të cilat kanë një lëvizje drejt përmirësimit, Kosova nuk ka lëvizur nga vlerësimet e viteve paraqake.

Viti 2015 ka qenë një vit i humbur sa i përket luftës kundër korrupsionit për Kosovës. Prokurimi publik ka vazhduar

të jetë pikë e dobët, fondet publike keqpërdoren, ndërsa gjyqësia ka vazhduar të jetë e dobët në këtë luftë. Këto gjetje KDI i shpalosi në Ditën Ndërkombëtare Kundër Korrupsionit, 9 Dhjetor 2015 dhe ka kritikuar që vëmendja ndaj luftimit të kësaj dukurie këtë vit është zhvendosur te bllokada e Kuvendit. KDI vazhdon të kërkojë nga institucionet që të punojnë në projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit.



► KDI me aksion simbolik në Ditën Ndërkombëtare Kundër Korrupsionit, 9 Dhjetor 2015



Në mënyrë që programi TKK të arrijë misionin e tij, gjatë vitit 2015 janë zhvilluar tri projekte kryesore përmes të cilave është realizuar monitorimi i prokurimit publik në nivel qendror dhe lokal, janë prodhuar analiza për publikun dhe humtime kapitale për të vlerësuar integritetin institucional, është avokuar për ndryshim të ligjeve dhe praktikave të zbatimit të tyre, është ofruar përkrahje e drejtpërdrejtë për viktimat e korrupsionit si dhe janë realizuar aktivitete tjera që mbështesin qëllimet e këtij programi.

Statistikat e përgjithshme të programit:

- 8 Publikime/Analiza
- 1 Foto-kompeticion (130 fotografi)
- 6 Tryeza (180 pjesëmarrës)
- 10 Konferenca për Media
- 23 Komunikata për Media
- 1 Editorial
- 96 Artikuj në Media
- 35 Konsulta ligjore për viktimat të korrupsionit
- 1 Manual
- 7 Grupe të Fokusit (64 pjesëmarrës)
- 6 Vizita në terren me shtande
- 600 Broshura të shpërndara

2.1 RRITJA E EFIKASITETIT DHE TRANSPARENCËS SË SISTEMIT TË PROKURIMIT PUBLIK DHE REDUKTIMI I KORRUPSIONIT PËRMES MONITORIMIT AKTIV

E cilësuar si fushë me mundësi dhe shkallë të lartë korrupsioni, prokurimi publik ka vazhduar të jetë sektori me shpërfaqjen më të madhe të parregullësive dhe korrupsionit. Përmes monitorimit aktiv të procesit të prokurimit në nivel qendror dhe lokal, KDI ka synuar ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve në aktivitetet e prokurimit, menaxhimin më të mirë të parasë publike dhe parandalimin apo zvogëlimin e praktikave korruptive në këto institucione.

Prokurimi në nivel komunal

Gjatë 2015, KDI ka analizuar aktivitetet prokuruese në pesë komuna të Kosovës: Prishtinë, Gjiilan, Gjakovë, Prizren e Mamushë për tre tenderë: i) mirëmbajtjen e rrugëve, ii) furnizimin e komunës me naftë dhe iii) shtrimin e rrugëve me kubëza betoni. Analiza e përmbledhur krahasuese për këto aktivitete prokurimi ka synuar të vë në pah dallimet e komunave në realizimin e prokurimeve dhe shkëmbimin e rasteve të sukseshme të prokurimit.

GJETJET KRYESORE

- Institucionet lokale në të shumtën e rasteve kanë dështuar të marrin “vlerën për parane e shpenzuar” për shërbimet apo furnizimet e tyre. Për artikuj si nafta, disa komuna kanë paguar çmime më të larta se ato në tregun me pakicë dhe kjo për shkak të formës që kanë zgjedhur zyrtarët të tenderojnë naftën, e që nuk ka mundësuar marrjen e çmimit më të mirë.
- Mbikëqyrja joefikase e zbatimit të kontratave ka prodhuar cilësi të dobët të punëve apo furnizimeve
- Aplikimi I “çmimeve jo normalisht të ulëta” në raport me vlerën e punëve apo çmimeve të tregut ka rezultuar në kualitet të dobët të punëve, jetëgjatësi të shkurtër të projekteve dhe dëmtim të konkurrencës së mirëfilltë.


Nr.	Institucioni	Vlera e premiumit në euro	Fitim i fitimi në 10,000 litra (ilustrim)
1	Prizren	0.15	1500
2	Gjilan	0.0001	1
3	Gjakovë	0.04	400
4	Mamushë	0.10	1000



Prokurimi në nivel qendror

Përmes publikimit të Indeksit të transparencës për Prokurim Publik në nivel qendror, KDI ka matur shkallën e transparencës së institucioneve në 5 shtylla kryesore me gjithsejt 23 indikatorë. Njëzet (20) dikastere të Qeverisë, përfshirë këtu Zyrën e Kryeministrit janë matur dhe krahasuar në raport me i) Qasjen në dokumente publike, ii) Transparencën buxhetore, iii) Transparencën në prokurim, iv) Transparencën në ankande publike dhe v) Ankesat në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP). Matjet kanë synuar nxitjen e konkurrencës të shëndoshë midis këtyre institucioneve dhe bërjen publike të performancës së tyre në zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit.

Transparenca buxhetore



Prokurimi i Centralizuar

Në shkurt 2015, Qeveria aprovoi fillimin e aplikimit e prokurimeve të centralizuara përmes Agjencisë Qendrore të Prokurimit (AQP), për ç’gjë KDI kishte avokuar në vazhdimësi. Qëllimi i prokurimeve të centralizuara ishte që të sigurohej efektshmëri dhe kosto më e ulët për blerjen e mallrave dhe artikujve të interesit të përbashkët. KDI monitoroi kontratën e AQP-së për furnizim me karburante për 37 autoritete kontraktuese dhe analizoi procedurat e tenderimit dhe dhënies së kontratës dhe zbatimin e saj.

Rezultatet e para të prokurimit të centralizuar ishin mjaft pozitive. Edhe pse prokurimi i centralizuar është jo i favorshëm për bizneset e vogla dhe të mesme, krijon kushte më të favorshme për menaxhimin e kontratës.



Sipas planeve të prokurimit të dorëzuara në AQP nga autoritetet kontraktuese që kanë hyrë në kontratë të përbashkët, sasia e përafërt e nevojshme e këtyre derivateve është rreth katër (4) milion litra në vit

Për përpilimin e këtij raporti, KDI ka analizuar mbi 100 dokumente dhe publikime, me mbi 2,000 faqe, ka pasur dhjetra takime dhe biseda telefonike, dhjetra komunikime përmes postës elektronike, ka parashtruar 12 kërkesa për qasje në dokumente zyrtare, etj.

Tridhjetë e shtatë (37) Autoritetet Kontraktuese të përfshira në këtë kontratë kanë të buxhetuara së bashku mbi 110 Milion Euro në Mallrat dhe Shërbimet dhe Shpenzime Kapitale, ku rreth 50 Milion Euro shpenzohen përmes procedurave të Prokurimit Publik. Rreth 10% këtyre shpenzime janë të planifikuara për prokurimin e karburanteve, të cilat përfshijnë naftë për automjete, benzinë për automjete, naftë për gjenerator dhe naftë për ngrohje.



► Foto nga lansimi i analizës: Paraja Publike apo Konkurrenca, 2015





ARRITJET KRYESORE TË PROJEKTIT

- Aplikimi i prokurimit të centralizuar, respektivisht kontrata kornizë e monitoruar për blerjen e derivateve tregoi për kursime në buxhetin e Kosovës në vlerë mbi 700,000 Euro.
- Nuk janë miratuar ndryshimet kozmetike të propozuara nga Qeveria për konfliktin e interesit nga presioni organizatave KDI dhe Çohu! Ato u shprehën kundër miratimit të Projektligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në formën aktuale (me ndryshime kozmetike nga ligj baziki) nga Komisioni për Legjislacion, pasi ky projekt-ligj nuk ligj nuk i adreson rekomandimet e ofruara nga OSHC-të dhe nuk është në harmoni me standardet evropiane siç edhe e ka përmendur Raporti i Progresit për Kosovën, i publikuar më 10 nënto3 2015. KDI dhe Çohu! i kanë rekomanduar Kuvendit të ndërmarrë një nismë të re ligjore me anë të së cilës do të ndryshoj në thelb ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit duke u bazuar në rrethanat e vendit dhe ne standardet evropiane. Raporti i Progresit për Kosovën ka kërkuar që ky dhe ligje tjera të jenë në harmoni me standardet evropiane. Në veçanti ka kërkuar që të përcaktohen qartë kategoritë e zyrtarëve publikë dhe masat në parandalimin dhe sanksionimin e konfliktit të interesit. Ndër të tjerat, është kërkuar që kategori të caktuara të zyrtarëve publikë sikurse këshilltarët politikë të mos përjashtohen nga fushëveprimi i ligjit.

Manuali i Monitorimit të Prokurimit Publik

Përvojat praktike shumëvjeçare në monitorimin e prokurimit publik të kombinuara me ekspertizën ndërkombëtare, KDI është përpjekur t'i sjellë në një format të përdorshëm dhe të dobishëm për organizatat e shoqërisë civile, mediat dhe hulumtuesit e pavarur. Gjatë 2015 është punuar në draftimin, editimin dhe dizjanimin e manualit, ku janë gërshetuar njohuritë teorike dhe praktike për monitorimin e prokurimit publik. Manuali do të shërbejë si mjet praktik për të trajnuar hulumtuesit e pavarur, OJQ-të, mediat etj dhe për t'iu shërbyer atyre gjatë monitorimit.

Statistikat e projektit

- 6** Publikime
- 5** Tryeza > 120 Pjesëmarrës
- 5** Fokus Grupe > 40 pjesëmarrës
- 5** Konferenca për Shtyp
- 17** Komunikata për Shtyp
- 41** Artikuj në Media
- 1** Editoriale
- 1** Manual


2.2 FORCIMI I SISTEMEVE NDËRKOMBËTARE TË INTEGRITETIT NË BALLKANIN PERËNDIMOR DHE NË TURQI

Gjatë 2015-tës, KDI si pjesë e rrjetit (TI) Transparency International ka vazhduar zbatimin e projektit mbi Vlerësimin e Sistemit të Integritetit Kombëtar (NIS). Në nëntor, KDI publikoi versionin e përditësuar të studimit mbi Sistemit të Integritetit Kombëtar, fillimisht të publikuar më 2011. Ky studim voluminoz prej 250 faqesh kishte për qëllim të vlerësojë nëse ka pasur progres në katër vitet e fundit sa i përket sistemit të integritetit në vend dhe të identifikojë rekomandimet dhe prioritetet e avokimit për të përmirësuar sistemin e integritetit në vend. Pesëmbëdhjetë (15) institucione duke filluar nga qeveria dhe parlamenti, shoqëria civile dhe mediat janë ekzaminuar për të vlerësuar efektshmërinë e institucioneve të Kosovës në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe në nxitjen e transparencës dhe integritetit.

Ky projekt është koordinuar në partneritet me 6 organizata partnere të rajonit, Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë.

GJETJET KRYESORE

- Legjislati i Kosovës sa i përket luftimit të korrupsionit është kryesisht adekuat, por zbatimi i tij në praktikë është i pamjaftueshëm. Veprat korruptive, nëse arrijnë të sanksionohen, rezultojnë me “dënime të buta”. Ndodhë që gjykatat të keqinterpretojnë ligjin dhe të shqiptojnë gjoba në vend të dënimit me burgim
- Ekziston një mungesë e bashkëpunimit në mes të institucioneve dhe aktorëve të përfshirë në luftën kundër korrupsionit, pavarësisht nga një sërë nismash dhe strategjish kundër-korrupsion të formuara nga shteti.
- Mungesa e vullnetit politik dhe vizionit në luftën kundër korrupsionit. Pavarësisht retorikës politike të qeverisë në shpalljen e tyre si prioritetet e politikave, ato kanë dështuar në trajtimin e tyre si të tilla në realitet.



Procesi i vlerësimit të integritetit kombëtar në Kosovë ka pasur një komponent të fortë konsultativ, duke kërkuar përfshirjen e aktorëve kryesorë të anti-korrupsionit në qeveri, shoqëri civile dhe sektorë të tjerë relevant. KDI-TI Kosovë ka tërhequr një analizë të grupeve të interesit që përfshinin Grupin Këshillues dhe Listën e informatorëve të cilët ishin të përfshirë në hulumtim. Grupi Këshillues prej 12 individësh i përbërë nga zyrtarë të lartë publik të qeverisë, gjyqësisë, institucionet e pavarura deri tek aktivistët kryesorë të shoqërisë civile, përfaqësues të biznesit dhe zyrtarë të organizatave ndërkombëtare ka dhënë një kontribut të çmuar në validimin e të gjeturave dhe i ka dhënë një konfidencë të shtuar këtij punimi.

Pas publikimit të raportit NIS janë identifikuar çështjet thelbësore, për të cilat KDI do të avokojë dhe t'i shtyjë përpara. Këto çështje përfshijnë: 1) Ndërtimin e politikave për thjeshtësimin e mekanizmave institucionalë kundër-korrupsionit 2) Përmirësimin e demokracisë së brendshme të subjekteve politike përmes krijimit të ligjit për subjektet politike dhe 3) Reformimin e sektorit të Drejtësisë.





ARRITJET E PROJEKTIT

- Skenimi i përgjithshëm i sistemit dhe integritetit institucional, i përcjellur nga rekomandimet specifike për secilin nga 15 sektorët ose institucionet vitale të shtetit
- Pas reagimeve të shumta të organizatave si KDI, Çohu dhe FOL lidhur me me iniciativën e Ministrisë së Drejtësisë për të dekriminalizuar mosdeklarimin ose deklarimin e rrejshëm të pasurisë nga zyrtarët e lartë publik, kjo e fundit më 8 prill ka tërhequr

propozimin nga procedura parlamentare dhe Neni 437 i Kodit Penal do të vazhdojë që të sanksionojë penalisht zyrtarët që nuk deklarojnë apo deklarojnë rrejshëm pasurinë e tyre. OSHC-të e kanë cilësuar të dëmshme mundësinë e mosdënimit të zyrtarëve publik për deklarimin e rrejshëm të pasurisë së tyre dhe e kanë vlerësuar këtë gjë vepër penale.



Statistikat e Projektit

- 1 Publikim Analizë mbi Sistemi i Integritetit Kombëtar (SIK)
- 1 Tryezë/Punëtori nacionale (mbi 60 pjesëmarrës)


- 2 Fokus Grupe (24 pjesëmarrës)
- 1 Komunikatë për Shtyp
- 15 Artikuj në media

2.3 QENDRA PËR AVOKIM DHE KËSHILLA LIGJORE- ALAC


Qendra për Avokim dhe Këshilla Ligjore është riaktivizuar nga KDI dhe Transparency International në mars të 2015-tës me synim që t'u gjendet pranë viktimave, denoncuesve, dëshmitarëve dhe "sinjalizuesve" të korrupsionit duke u dhënë atyre këshilla ligjore pa pagesë. KDI me këtë shërbim ka tejkaluar mbështetjen klasike të palëve, duke bërë një hap tutje në avokimin e këtyre rasteve dhe informimin e drejtpërdrejtë të qytetarëve. Qytetarët që dëshirojnë të raportojnë rastet e tyre mund të thërrasin në numrin e telefonit pa pagesë 0800 77 777, të komunikojnë përmes adresës elektronike info@kdi-kosova.org apo edhe vizitojnë zyret e KDI-së. Qendra përmes ekipit të saj ofron a) ndihmesë në përpilimin juridik të rastit b) orienton palën në adresimin e problemit të raportuar c) përcjell ecurinë e rastit të raportuar. Gjatë 2015-tës, KDI ka ofruar ndihmë për 35 denoncues/viktima të korrupsionit.

Qendra ka realizuar aktivitete mobile duke vendosur shtandet në 5 komunat më të mëdha të Kosovës dhe duke ofruar informata për qytetarët lidhur me shërbimet që ofron. Përveç kësaj, ka realizuar vizita në fakultetet e Universitetit të Prishtinës për të diskutuar me studentët dhe ka promovuar aktivitetin e saj përmes mediave.

SIPAS MËNYRËS SË PËRFSHIRJES NË RAST, P.SH. A ËSHTË VIKTIMË, DËSHMITAR, SINJALIZUES ETJ. KEMI NDARJEN NË VIJIM:



GRAFIKU I MËPOSHTËM PARAQET NATYRËN E RASTEVE TË RAPORTUARA:





ARRITJET KRYESORE

- Anulimi dhe vendosja nën hetime e tre tenderëve në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, të dyshuar për kurdisje dhe favorizim
- Anulimi i tenderit në Ministrinë e Administratës Publike
- Anulimi i përzgjedhjes së stafit akademik në UP ku kishte nepotizëm, si dhe ndërrimi i mënyrës të rekrutimit, duke vendosur që në të ardhmen Senati i UP-së të bëjë përzgjedhjen për stafin e të gjitha fakulteteve
- Marrja e informatave për statusin e shumë lëndëve (të raportuara në Qendër) të zvarritura nga gjykatat dhe prokuroritë e të gjitha niveleve dhe shtyrja e tyre përpara duke fuqizuar ankuesit për kërkim të të drejtave të tyre



► Foto nga Marshi në mbështetje të sinjalizuesve të korrupsionit, gusht 2015

KDI ka mbështetur nismën e OSHC-ve për amendamentimin e Ligjit për Mbrojtjen e Informatorit në përputhje me standardet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe trajtimin e rasteve konform këtyre standardeve. Rasti I sinjalizuesit e korrupsionit, Abdullah Thaçi më 2015 ishte një shembull i dënimit të sinjalizuesve për denocimin e korrupsionit për të mirën publike. KDI ka kërkuar që sinjalizuesit të mos frikësohen e ndëshkohen, por të inkurajohen.

KDI ka reaguar edhe në rastin e ish- prokurores së EULEX, Maria Bamieh për sinjalizimin e dyshimeve për keqmenaxhim brenda misionit EULEX. KDI ka kërkuar nga EULEX-i që të bëjë publike procedurat për raportimin e keqpërdorimeve dhe mbrojtjen e sinjalizuesve me qëllim të luftimit dhe parandalimit të tyre. EULEX-i duhet të jetë shembull se si duhet trajtuar një sinjalizues i korrupsionit për të përmirësuar situatën në vend se të dërgojë mesazhin që kushdo që flet për korrupsionin do të përballet me kërcënimin për t’u ndjekur penalisht.

▼ Statistikat e projektit

- 1** Publikim
- 5** Konferenca për media
- 5** Komunikata për media
- 40** Artikuj në media
- 35** Raste të raportuara
- 6** Vizita në terren me shtande
- 600** Broshura të shpërndara
- 1** Foto kompeticion 130 foto



euronews.
NEWS EUROPEAN AFFAIRS BUSINESS SPECIAL REPORTS SPORT CULTURE NO COMMENT SCI-TECH
Africa Americas Asia Europe Middle East
LUXURY TRAVEL

Try our new website ↗

All Programmes Extras Weather

home News World news EULEX should 'stop intimidating whistleblowers' – campaigners

chrome Get a fast, free web browser from Google.

Download Now

NEWS

EULEX should 'stop intimidating whistleblowers' – campaigners

By [Chris Harris](#) Follow @yonanglais

13/08/15 13:05 CET | updated at 13/08 - 14:55

Anti-corruption campaigners have called on the EU's largest foreign mission to stop [intimidating whistleblowers](#).

Transparency International says EULEX – a €111-million-a-year operation to establish the rule of law in Kosovo – should instead publish procedures outlining what protection it offers to those reporting alleged internal fraud.

Whistleblower Maria Bamieh claimed last year that EULEX had covered up a case of corruption in its own ranks, an accusation later dismissed by an independent investigation.

Representatives for Bamieh, who is now taking the EU agency to an employment tribunal, say she has received a letter from EULEX's lawyers threatening prosecution if she discloses details of her legal case to outsiders.

EULEX says it "has not and will not threaten anyone with the aim to silence individuals or prevent their access to the media".

Edita Mustafa, programme manager at Transparency International Kosovo, said: "Transparency International Kosovo requests that EULEX publishes the procedures for reporting fraud and protection of whistleblowers. This is so that cases of corruption or misuse of power within this Institution, or other Institutions where EULEX operates, are made public in order to combat and prevent such abuses."

euronews LIVE

euronews RADIO

Latest Bulletin

London

21° / 10°

More Weather...

euronews.

ALL VIEWS

WE HAVE LAUNCHED A NEW BETA SITE

LEARN MORE HERE

[advertisement]

Try our new look

Visit our new beta website

72%


Check it out

Most Viewed

	Today	Yesterday	7 Days
1	Johnny Depp's wife granted domestic violence restraining order		
2	more storms on the horizon as lightning strikes Europe		
3	German MP suffers 'cake attack' over refugee stance		
4	In the EU 'one in three deaths of under-75s is avoidable,' says Eurostat		
5	France's fuel crisis better but not yet over		

KDI në Gazetën Ndërkombëtare Euronews





Artan Canhasi per gazeten Die Zeit, 25 Gusht 2015

Dita Ndërkombëtare Kundër-korrupsionit, 9 Dhjetori është shënuar simbolikisht edhe me shpalljen e fituesve të garës fotografike #fajikorrupsionit, e organizuar nga KDI në bashkëpunim me UNDP. Kjo garë ka pasur për qëllim paraqitjen e efekteve shkatërruese që jep korrupsioni. Në garë kanë aplikuar mbi 100 persona duke postuar mbi 130 foto në rrjetet sociale Facebook, Twitter, Instagram me hashtagun

#fajikorrupsionit (si dhe në gjuhët e tjera #becauseofcorruption apo #zbogkorupcije). Në këtë ditë janë ekspozuar 20 fotot më të mira sipas jurisë së përbërë nga pesë anëtarë (gazetar, fotograf profesionist dhe përfaqësues nga KDI dhe UNDP). Të gjitha fotot e ekspozuara kishin mesazhet e veta të fuqishme, që më së miri u përshkruan nga Arbër Elezi, njëri nga fituesit e garës.

SINJALIZUESIT E KORRUPSIONIT
MOS TË NDËSHKOHEN POR TË INKURAJOHEN



Kontribuo



Kontributet tuaja mund t'i depononi në xhirollogarinë e Abdullahut:
 Banka: Banka Kombëtare Tregtare, Dega: Prizren
 Mbajtësi i llogarisë: Abdullah Thaçi
 Numri i llogarisë: 1911695541021123
 Swift kodi: NCBAXKPR





Si mësues në shkollën e muzikës në Gjilan, është tepër rëndë të fotografosh nxënësit e tu duke mbledhur mbeturina. Ata kërkuan që unë të mos e publikoj këtë foto, por unë nuk mundem të mos e publikoj realitetin e hidhur dhe gjendjen e rëndë që këta po përjetojnë”.

✓ Foto të përzgjedhura nga Gara për foton më të mirë kundërkorrupsion







PROGRAMI:
ZGJEDHJET E LIRA
DHE TË DREJTA
(ZLD)

ANËTARËSIMI I KDI/DNV NË ENEMO – PËR HERË TË PARË NË UKRAINË



Viti 2015 ka shënuar të arritura të rëndësishme për KDI-në si organizatë udhëheqëse e koalicionit të OJQ-ve për vëzhgimin e zgjedhjeve “Demokracia në Veprim (DnV)”. Në Kuvendin e Përgjithshëm të ENEMO-së (Rrjetit European të Organizatave për Monitorim të Zgjedhjeve) të mbajtur në Shkup të Maqedonisë më 18-20 shkurt të këtij viti, Asambleja e Përgjithshme miratoi anëtarësimin e KDI/DnV në këtë rrjet. Si anëtare e asociuar e këtij rrjeti, KDI për herë të parë fitoi të drejtën për pjesëmarrje të barabartë në misionet ndërkombëtare për vëzhgimin e zgjedhjeve. Në këtë kontekst, një vëzhgues afatshkurtër nga KDI u bë pjesë e misionit vëzhgues të ENEMO-së në zgjedhjet lokale në Ukrainë të mbajtura më 25 tetor 2015. Përcjellja nga afër e procesi zgjedhor në një shtet me më shumë se 45 milion banorë, ishte përvojë jashtëzakonisht e çmueshme për Demokracinë në Veprim dhe do të shërbejë për avansimin e përvojave në monitorimit të proceseve zgjedhore.

Statistikat e përgjithshme të programit:

- 3** Procese Zgjedhore të monitoruara (Dy ndërkombëtare dhe 1 vendore)
- 37** Vëzhgues vendorë e ndërkombëtarë
- 10** Vëzhgues afatshkurtër (STO) të çertifikuar nga OSBE/ODIHR
- 3** Publikime
- 6** Komunikata për media
- 1** Konferencë për media
- 6** Infografika
- 9** Trajnime (204 pjesëmarrës)
- 4** Editoriale
- 3** Tryeza (65 pjesëmarrës)
- 1** Memorandum Mirëkuptimi

|||||

 **KDI's membership**

From: Nino Lomjaria (nino.lomjaria@isfed.ge)

Sent: Mon 3/23/15 12:43 PM

To: jbakija@kdi-kosova.org; ismetkryeziu@gmail.com; vismaili@kdi-kosova.org; 'Edita Mustafa' (edita_m@hotmail.com); dritonselmanaj@gmail.com

Cc: 'Darko Aleksov' (darko.aleksov@enemo.eu); 'Marko Ivkovic' (mivkovic@ndi.org); 'Venco Popovski' (venco.popovski@enemo.eu); 'Zlatko Dimitrioski' (zlatko@most.org.mk); 'Mikheil Benidze' (mbenidze@isfed.ge)

Dear friends,

I am Nino Lomjaria, Secretary General of ENEMO and an executive director of International Society for Fair Elections and Democracy (ISFED) from Georgia.

I would like to officially inform you that KDI's application for ENEMO membership has been accepted by the General Assembly, held in February, 2015. Please, accept my congratulation! We are looking forward to cooperating with you!

Here, I would like to provide information about the status, rights and responsibilities of the newly elected members (please, find attached the relevant chapter of the Constitutional Protocol of ENEMO). Please, take into mind that according the Constitutional Protocol "When a new organization joins the Network, it receives the status of an associate member, or the status of a consultative member, depending on its projects and activities.

An associate member may apply for full membership after two years since it has joined the Network. The decision for granting full membership status is made by the General Assembly with 2/3 majority of the total number of full members."

Accordingly, KDI has received the status of an associate member and therefore you can apply for full membership after two years.

Please, don't hesitate to contact me if you have any further questions.

Best regards,

Nino Lomjaria
Executive Director

Address: Oniashvili St. 37, Tbilisi 0160, Geo
Tel: +995 32 2372882 / Cell: +995 555 020200
Email: lomjaria@isfed.ge
www.isfed.ge

|||||

3.1 MBËSHTETJE PËR MONITORIM TË ZGJEDHJEVE VENDORE

Vëzhgimi i Zgjedhjeve për Kryetar të Komunës së Graçanicës, Janar 2015

Zgjedhjet e jashtëzakonshme të 18 janarit, 2015 për të parin e komunës së Graçanicës erdhën si rezultat i dorëheqjes së z. Branimir Stojanović nga posti i kryetarit pas emërimit të tij në një nga katër postet e zëvendëskryeministrave të Kosovës. Kjo dorëheqje, pas një viti në udhëheqje të qeverisjes lokale, ligjërisht çoi Komunën e Graçanicës në zgjedhje të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës. KDI si organizatë udhëheqëse e koalicionit të organizatave vendore për monitorim të zgjedhjeve Demokracia në Veprim mobilizoi vëzhguesit e saj për të vëzhguar procesin zgjedhor dhe për të siguruar që këto zgjedhje të ishin të lira, të drejta dhe demokratike. Përcjellja e fushatës zgjedhore prej pesë-ditëve, vëzhgimi i ditës së zgjedhjeve, përfshirë këtu procesin e votimit dhe numërimit dhe edukimi i votuesve ishin fushat ku *Demokracia në Veprim* koncentroi aktivitetin e saj. 27 vëzhgues mbuluan të 27-vendvotimet e përcaktuara ndërsa Qendra e thirrjeve e funksionalizuar

Statistikat e projektit:

- 1 Zgjedhje lokale të monitoruara (30 vëzhgues)
- 1 Publikim
- 4 Komunikata për Media
- 3 Trajnime 54 pjesëmarrës
- 3 Artikuj në media
- 1 Tryezë
- 2 Vizita me shtande, Dil e Voto (300 broshura)

enkas për ditën e zgjedhjeve, ka ndihmuar në grumbullimin e të dhënave nga vëzhguesit në terren lidhur me ecurinë e procesit, daljen e qytetarëve në zgjedhje, parregullsitë eventuale dhe rezultatin preliminar të zgjedhjeve. Këto të dhëna i janë komunikuar publikut gjatë gjithë ditës përmes komunikatave për shtyp.



► KDI/DnV vëzhgon zgjedhjet lokale në Ukrainë, Tetor 2015



► Vullnetarët e DnV-së në fushatën “Dil e Voto” në Graçanicë, Janar 2015



► Vullnetarët e DnV-së në Qendrën e Thirrjeve, CPT në Graçanicë, 18 Janar 2015



Demokracia në Veprim' vëzhgoi zgjedhjet lokale të 21 Qershorit në Shqipëri

Një kontigjent prej 6 vëzhguesish afatshkurtër nga koalicioni i organizatave vendore për monitorim të proceseve zgjedhore 'Demokracia në Veprim', ka qëndruar në Shqipëri nga 19-22 qershor për të monitoruar përmbylljen e fushatës zgjedhore dhe ditën e zgjedhjeve. Tre ekipe vëzhguesish, ndër tjerash kanë përcjellur me vëmendje respektimin e heshtjes zgjedhore në bashkinë e Tiranës, Vorës dhe Durrësit dhe kanë ndjekur disa nga punimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Në ditën e Zgjedhjeve, përveç monitorimit të hapjes së qendrave të votimit, procesit të votimit dhe mbylljes së qendrave të votimit, është monitoruar edhe bartja e kutive të votimit në Komisionet Zonale të Administrimit të Zgjedhjeve, si dhe procesi i numërimit të fletëvotimeve. DnV kishte rastin të të takohet edhe me organizatën partnere 'KRILK Albania', poashtu pjesë të rrjetit europian të organizatave për monitorim të zgjedhjeve, ENEMO. Për më tepër, vëzhguesit e DnV-së kanë takuar drejtuesit e 'Koalicionit për Zgjedhje të Lira e të Ndershme e për Demokraci të Qëndrueshme, dhe janë njoftuar për së afërmi me aktivitetet e tyre, sidomos rrjedhën e mbledhjes së informatave nga qendra e thirrjeve, procesimin e të dhënave në qendër dhe konferencat për media.

Mësimet e nxjerra nga vëzhgimi i zgjedhjeve në Shqipëri, dhe praktikrat e mira të organizatave për monitorim të zgjedhjeve atje, do të ndahen me të gjitha organizatat anëtare të DnV-së. Dërgimi i vëzhguesve tanë në Shqipëri është mbështetur nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, në kuadër të projekti për ngritje të kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile për monitorim të proceseve zgjedhore.



► KDI/DnV vëzhgon fushatën dhe zgjedhjet lokale në Shqipëri, Qershor 2015



► Foto nga Dita e Zgjedhjeve, Shqipëri, Qershor 2015

Vëzhguesit afatshkurtër të zgjedhjeve të Demokracisë në Veprim certifikohen nga ODIHR

Me anëtarimin e Demokracisë në Veprim në rrjetin evropian të organizatave për monitorim të zgjedhjeve, ENEMO në shkurt të këtij viti, vëzhguesve të DnV-së do t'u hapen mundësi për të qenë pjesë e misioneve vëzhguese edhe jashtë Kosovës. Pjesëmarrja në misione të strukturuar të vëzhgimit kërkon profesionalizëm, cilësi dhe njohje të mirë të procesit zgjedhor. Në këtë kontekst, është bërë një hap i rëndësishëm; më 30 prill, dhjetë vëzhgues të DnV-së patën rastin të ndjekin një kurs online të zhvilluar nga ODIHR për vëzhguesit e shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së. I përbërë nga katër module, kursi mbulon të gjitha aspektet e punës së vëzhguesve afatshkurtër, duke përfshirë standardet ndërkombëtare të zgjedhjeve, parimet dhe qëllimin e vëzhgimit të zgjedhjeve, strukturën e misioneve të vëzhgimit të zgjedhjeve, aktivitetet e përditshme të vëzhguesit afatshkurtër si dhe Kodin e Mirësjelljes së vëzhguesit. Në fund të trajnimit, vëzhguesit me sukses kanë përfunduar procesin e testimit dhe janë pajisur me Certifikatë të ODIHR-it. Ky aktivitet unik është mundësuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, në kuadër të aktiviteteve për ngritje të kapaciteteve të shoqërisë civile në Kosovë.

Reforma Zgjedhore

Ndonëse aktivizimi i reformës zgjedhore tash sa kohë është peng i vullnetit politik, KDI gjatë gjysmës së parë të vitit, ka vazhduar me aktivitete në funksion të adresimit të saj, sidomos pas deklaratave të disa eskponentëve politikë për vazhdimin e reformës zgjedhore dhe mundësinë e mbylljes së listave. Duke aluduar në përfundimin e mandatit të Presidentes Jahjaga në pranverë 2016, debatet për mënyrën e zgjedhjes së Presidentit, mospërfundimin të projekt-ligjit për zgjedhjen e Presidentit nga legjislatura e mëhershme dhe deklaratimet se zgjedhja e drejtpërdrejtë e presidentit ndryshon edhe sistemin parlamentar të qeverisjes në Kosovë, KDI ka publikuar punimin diskutues “Zgjedhja e Presidentit nga populli: Nevojë e kohës apo retorikë e zakonshme?”. Qëllimi i punimit ishte të hapë një diskutim të gjerë shoqëror e politik, bazuar në perspektivat dhe përvojat rajonale e më gjerë mbi mënyrën dhe parametrat tjerë të zgjedhjes së presidentit në vend. KDI beson që ky proces domosdo duhet të jetë i hapur për qytetarët dhe të reflektojë preferencat e tyre. Në këtë kontekst, është realizuar edhe një anketë me qytetarë gjithandej Kosovës, ku 89.7% e të anketuarve janë shprehur në favor të zgjedhjes së drejtpërdrejtë të presidentit nga populli.

Në këtë punim, në mënyrë kronologjike janë analizuar proceset politike dhe procedurat e zgjedhjes së presidentëve që nga pas-lufta në Kosovë, rezultatet e punës së komisionit për ndryshimet kushtetuese për zgjedhjen e drejtpërdrejtë të Presidentit dhe janë zbërthyer procedurat e parapara në Draft-ligjin për Zgjedhjet Presidenciale përfshirë aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese. Pjesa vijuese e punimit përqendrohet në krahasimin e kompetencave dhe mënyrës së zgjedhjes së presidentëve në vendet me sistem parlamentar të qeverisjes, me fokus në vendet e rajonit, mandatet dhe kriteret e kandidimit

Cilin sistem të zgjedhjes së Presidentit preferoni:





ARRITJET E PROJEKTIT

- KDI/Demokracia në Veprim anëtarësohet në European Network of Election Monitoring Organizations -ENEMO
- KDI/Demokracia në Veprim merr pjesë në kontigjentin e vëzhguesve ndërkombëtarë të ENEMO-së për monitorimin e zgjedhjeve lokale në Ukrainë, tetor 2015
- Tre palë zgjedhje, 1 vendore dhe 2 ndërkombëtare të monitoruara
- Dhjetë (10) vëzhgues të DnV të certifikuar si vëzhgues afatshkurtër nga OSBE/ODIHR



Statistikat e Projektit:

2 Publikime

1 Konferencë për media

1 Komunikatë për media

2 Zgjedhje ndërkombëtare të monitoruara (7 Vëzhgues)

7 Artikuj në Media

1 Editoriale



3.2 PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR MONITOROJNË QASJEN E TYRE NË ZGJEDHJE

Angazhimi i personave me aftësi të kufizuara si vëzhgues të proceseve zgjedhore, posaçërisht si vëzhgues afatgjatë është i rrallë në botë. Në kuadër të Demokracisë në Veprim më 2014 u angazhuan afër 300 persona me aftësi të kufizuara dhe kjo shënoi rastin e parë në botë. Angazhimi i suksesshëm i tyre në këtë ndërmarrje, rezultoi me nevojën që kjo qasje të instiucionalizohet. Me përkrahjen e IFES, KDI/DnV së bashku me OJQ-të e aftësive të kufizuara krijoi Grupin Punues për Qasje Zgjedhore të përbërë nga përfaqësues të KQZ-së, OJQ-ve që trajtojnë aftësitë e ndryshme të kufizuara, deputetë të Kuvendit të Kosovës etj me qëllim të gjetjes së mundësive dhe koordinimit e veprimeve institucionale që do t'i kontribuonin rritjes së pjesëmarrjes së PAK në procese zgjedhore. Aktualisht në Kosovë personat me aftësi të kufizuara kanë qasje të limituar në procese elektorale, duke filluar nga dita e votimit, ku u mungon qasja fizike, qasja në informata e deri tek pjesëmarrja aktive në trupat e menaxhimit të zgjedhjeve.

Statistikat e Projektit

- 2 Tryeza
- 2 Editoriale
- 6 Trajnime për avokim për Persona me Aftësi të Kufizuara-PAK 150 pjesëmarrës
- 1 Memorandum Mirëkuptimi



► Foto nga tryeza me Grupin Punues për Qasje Zgjedhore





ARRITJET E PROJEKTIT

- Më 16 tetor, 2015 u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit midis Trupave Menaxhuese Zgjedhore, përkatësisht KQZ dhe OSHC-ve që merren me aftësinë e kufizuar, e që mundëson angazhimin e personave me aftësi të kufizuar në pozita të ndryshme si staf zgjedhor.
- Grupi Punues shumë-akterësh ka tejkaluar veten duke krijuar një vizion dhe një plan pune për trajtimin e çështjes së qasshmërisë së PAK në proceset politike dhe zgjedhore, dhe duke implementuar aktivitetet dhe duke fuqizuar politikën që kanë ndikim. E gjithë kjo, brenda 10 muajve. Kjo tregon se si akterët kanë marrë pronësinë dhe janë duke adresuar çështjet e qasshmërisë”, tha Sarah Buchanan, Drejtoreshë e Programit për Demokratizim dhe Qeverisje të USAID në Kosovë.



**PROGRAMI:
QEVERISJA
LOKALE DHE
PJESËMARRJA
QYTETARE
(QLPQ)**

Në kuadër të angazhimeve për të avancuar qeverisjen lokale, KDI ka vazhduar me publikimin e fletënotimeve për kuvendet komunale të rajonit të Prizrenit, ku është vlerësuar performanca e këshilltarëve komunalë dhe subjektve politike të përfaqësuar. Transparencë është nxjerrë në baza periodike për 11 komuna të Kosovës dhe ka vënë në pah dobësitë e institucioneve lokale karshi transparencës që këto institucione do të duhej të ofronin për qytetarët e tyre. Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal, ka vlerësuar metodologjinë dhe indikatorët që KDI përdorë në indeks, dhe ka vendosur që t'a përdorë këtë qasje ose 90% të të gjithë këtyre indikatorëve në funksionet e saj mbikëqyrëse të të gjitha komunave të Kosovës. KDI ka bërë punë të vlefshme në mobilizimin e qytetarëve për të ndikuar vendim-marrjen dhe për t'u përfshirë në këtë proces si aset i vlefshëm.


4.1. TRANSPARENCA INSTITUCIONALE NË NIVEL QENDROR DHE LOKAL

Përmes këtij KDI ka prezantuar nivelin e transparencës së 11 komunave për periudhën gjashtëmujore janar-qershor 2015. Komunitat e targetuara përfshijnë: Prishtinën, Prizrenin, Gjakovën, Gjilalin, Suharekën, Deçanin, Graçanicën, Rahovecin, Malishevën, Dragashin dhe Mamushën.

Indeksi i përbërë nga 44 indikatorë ka vlerësuar transparencën e komunave në katër shtyllat themelore të qeverisjes lokale si: Zyra e Kryetarit/es, Kuvendi i Komunës, Financat e Komunës dhe Transparenca e Komunës në Konsultime me Publikun. Gjashtë nga 11 komunat e përfshira në hulumtim, si Prishtina, Prizreni, Gjakova, Gjilani, Deçani dhe Graçanica ishin vlerësuar edhe për periudhën paraprake prill-shtator 2014. Rezultatet treguan për avansim, respektivisht regres të komunave në transparencë.

Komuna e Prishtinës u vlerësuar për rritje të nivelit të transparencës, prej 55.7% sa ishte vitin e kaluar në 70.8% në gjashtëmujorin e parë të 2015-tës. Komuna e Gjakovës, e cila në Transparencën e kaluar kishte pikë maksimale dhe ishte vlerësuar si komuna më transparente (76.4%), në këtë periudhë ka treguar rënie të nivelit të transparencës (64.5%). Ndërkohë që Prizreni nuk ka shënuar ndonjë përmirësim dhe nuk ka reflektuar nga rekomandimet e adresuara në vitin e kaluar.

Vlerësimi i përgjithshëm për 6 mujorin e parë 2015 nxjerr edhe komunën më transparente që është ajo e Prishtinës me 70.8%, pasuar nga Gjilani me 66.7%, Gjakova 64.5%, Deçani 51.2%, Malisheva 42.1%, Rahoveci 40.7%, Prizre-



ni 39.3%, Graçanica 35.0%, Suhareka 34.1%,. Me nivel të ulët të transparencës kanë rezultuar Dragashi dhe Mamusha me vetëm 19.8%.

Statistikat e Projektit

- 1 Publikim
- 1 Komunikatë për Media
- 1 Konferencë për shtyp
- 5 Artikuj në media



4.2 PËRMIRËSIMI I TRANSPARENCËS KOMUNALE PËRMES TRANSPAROMETRIT KOMUNAL

Projekti ka synuar të përmirësojë transparencën e 6 komunave (Prishtinë, Prizren, Gjiilan, Gjakovë, Deçan dhe

Graçanicë), përmes aplikimit të matjeve periodike, të njohura si indikatorët e Transparometrit komunal. Këto matje të bazuara në 44 indikatorë skenojnë komunat në katër fushat thelbësore të qeverisjes lokale: transparencën e Kuvendit Komunal, transparencën e zyrës së kryetarit, transparencën financiare dhe transparencën në konsultime me publikun. Rezultatet e matjeve, apo indikatorët e transparencës u janë komunikuar zyrtarëve komunalë por edhe publikut të gjerë me qëllim të nxitjes së përmirësimit të dobësive. Nuk kanë munguar edhe refleksionet e komunave në përmirësim të transparencës.



► Foto nga punëtorja për zhvillimin e indikatorëve të transparencës KDI-MAPL



► Komunat diskutojnë për publikimin e raportit të shpenzimeve





ARRITJET E PROJEKTIT

- MAPL ka adoptuar dhe institucionalizuar shumicën e indikatorëve që KDI shfrytëzon për matjen e transparencës (Transparometrin) në komuna. Kjo metodologji do t'i shërbejë MAPL-së për matjen e transparencës në të gjitha komunat e Kosovës.
- KDI është përpjekur të sensibilizojë institucionet qendrore mbikqyëse të komunave mbi problematikën e menaxhimit të ueb faqeve komunale dhe nevojën e reformimit të tyre. Si rezultat i aktiviteteve avokuese, Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal përkrahur nga fondet zvicerane përmes Helvetas (Projekti Demos) ka incicuar hapjen e tenderit që parasheh ri-dizajnimin e ueb faqeve të komunave, të cilat edhe do të menaxhoheshin më lehtë nga komunat, edhe do të ofrojnë më shumë transparencë për qytetarët.

- Si rezultat i publikimit të transparometrit, komunat e targetuara në projekt, kanë shënuar përmirësime në indikatorët vlerësues si më poshtë:

- a) Komuna e Prishtinës ka publikuar procesverbalet e mbledhjeve të kuvendit të komunës (<https://kk.rks-gov.net/prishtina/Municipality/Assembly/Procesverbalet.aspx>) si dhe ka publikuar rregulloret dhe vendimet ne ueb faqen e komunës (<https://kk.rks-gov.net/prishtina/Municipality/Assembly/Regulations.aspx>)
- b) Komuna e Gjakovës ka krijuar linkun për draft dokumente ne nivel lokal ([https://kk.rks-gov.net/gjakove/Assembly/Raportet-Gjakove-\(1\).aspx](https://kk.rks-gov.net/gjakove/Assembly/Raportet-Gjakove-(1).aspx))
- c) Komuna e Gjilanit ka publikuar procesverbalet e mbledhjeve të kuvendit të komunës (<http://kk.rks-gov.net/gjilan/Municipality/Assembly/Procesverbalet.aspx>), ka publikuar buxhetin e komunës për vitin 2016 (<http://kk.rks-gov.net/gjilan/Projects/Budget.aspx>), ka filluar njoftimet për aktivitetet e prokurimit (<http://kk.rks-gov.net/gjilan/Prokurimi/Njoftim-per-kontrate.aspx>).
- d) Komuna e Deçanit ka publikuar të hyrat vetanake (<https://kk.rks-gov.net/decan/getattachment/9e121448-f3fa-454b-9235-b2fd5ea63b57/TE-HYRAT---2015.aspx>), ka filluar publikimin e konkurseve dhe kriteret për punësim (<https://kk.rks-gov.net/decan/Shpalljet/Konkurset.aspx>), ka filluar me publikimin e drafet rregulloreve komunale (<https://kk.rks-gov.net/decan/getattachment/3b76a90b-0fae-4108-b028-6aade8c27f38/PROPOZIM-RREGULLORE---PER-MBROJTJEN-E-TE-MITURVE-N.aspx>).
- e) Komuna e Graçanicës ka publikuar buxhetin e komunës për vitin 2016 (<https://kk.rks-gov.net/gracanice/Za-dokumenta-na-Srpskom/Budzet-2016-.aspx>)
- f) Komuna e Prizrenit ka publikuar raportet tre mujore financiare ([https://kk.rks-gov.net/prizren/Municipality/Departments-\(1\)/Ekonomi-dhe-Financa.aspx](https://kk.rks-gov.net/prizren/Municipality/Departments-(1)/Ekonomi-dhe-Financa.aspx)), buxhetin e komunës për vitin 2016 ([https://kk.rks-gov.net/prizren/Municipality/Departments-\(1\)/Ekonomi-dhe-Financa.aspx](https://kk.rks-gov.net/prizren/Municipality/Departments-(1)/Ekonomi-dhe-Financa.aspx)), raportin e auditorit te jashtëm (<https://kk.rks-gov.net/prizren/Municipality/Njesia-e-Auditimit-te-Brendshem/Raportet-e-Auditimit.aspx>)

Statistikat e Projektit:

1 Publikim

2 Tryeza (30 pjesëmarrës)

2 Punëtori (20 pjesëmarrës)

2 Konferencë për media

4 Komunikata për media

4 Debate Televizive

3 Infografika

20 Artikuj në media



DISA NGA INSTRUMENTET PËR NJË KOMUNË MË TË HAPUR

LINJAT TELEFONIKE PA PAGESË

Prishtinë
0800 1 22 33 - 0800 1 22 34
Gjakovë
0800 60 000 - 0800 60 001
Gjilan
0800 11 555
SKA LINJË TELEFONIKE PA PAGESË:
Prizren, Graçanicë, Deçan

DISA NGA INSTRUMENTET PËR NJË KOMUNË MË TË HAPUR

RAPORTET E SHPENZIMEVE

Prishtinë - Janar-Shtator
Gjilan - Janar-Shtator
Gjakovë - Janar-Qërshor
Prizren - Janar-Shtator
Graçanicë - Mungon raporti
Deçan - Mungon raporti

DISA NGA INSTRUMENTET PËR NJË KOMUNË MË TË HAPUR

MEDIAT SOCIALE (Like-s)

Prizren	2,007	Prishtinë	25,519
Graçanicë	2,958	Gjakovë	14,731
Deçan	3,216	Gjilan	10,607



4.3. PËRFSHIRJA QYTETARE PËR TRANSPARENCË DHE LLOGARIDHËNIE

Përmes këtij projekti KDI ka monitoruar punën e gjashtë komunave të regjionit të Prizrenit për të prodhuar Fletënotimin vjetor, tashmë jubilar, ku është shpalosur performanca e 180 zyrtarëve të zgjedhur të këtij rajoni për 2015. Rreth 76 sesione të mbledhjeve të asambleve komunale janë monitoruar de përcjellur gjatë vitit. Përveç kësaj është publikuar edhe Transparometri i bazuar në 44 indikatorë të grupuar në 4 shtylla: Kuvendi Komunal, Zyra e Kryetarit, financat e komunës dhe konsultimet publike. Ky indeks ka bërë që komunat të jenë më transparente, veçanërisht në publikimin e vendimeve të tyre, rregulloreve, planeve të investimit apo raporteve tremujore te shpenzimeve në ueb-faqet e tyre.

Në përpjekje për një vendim-marrje të bazuar me input qytetar, KDI ka fascilituar dëgjime publike me pjesëmarrje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe qytetarëve, ku këta të fundit kanë artikulluar kontributin e tyre ne planifikimet buxhetore.

QEVERISA LOKALE DHE PËRËMARRJA QYTETARE
 REZULTATET E FLETËNOTIMIT PËR ANËTARËT E KUVENDIT

KUVENDI I KOMUNËS PRIZREN

№. ANËTARIT	Emri	Partia	Titulli	Adresa	Telefon	Adresa	Telefon	Adresa	Telefon	Adresa	Telefon
1	Nezir Dauti***	PSM	0	60	0	0	0	0	0	0	0.0%
2	Alban Haxhi	PSM	6	212	0	176	0	0	0	0	6.2%
3	Mirza Lazi	PSM	0	20	0	10	0	0	0	0	0.0%
4	Edmond Uroci	PSM	0	49	1	79	0	0	0	0	0.0%
5	Kadri Krasniqi**	PSM	0	8	26	15	0	0	0	0	0.0%
6	Edmond Krasniqi**	PSM	0	26	0	26	0	0	0	0	0.0%
7	Edmond Krasniqi*	PSM	1	49	0	19	0	0	0	0	1.7%
8	Agim Uroci	PSM	0	28	0	9	0	0	0	0	0.0%
9	Salih Mami	PSM	0	8	1	9	0	0	0	0	0.0%
10	Feriz Uroci	PSM	0	64	3	49	0	0	0	0	0.0%
11	Mirza Mami**	PSM	4	142	24	111	0	0	0	0	6.9%
12	Edmond Krasniqi	PSM	0	8	0	10	0	0	0	0	0.0%
13	Edmond Krasniqi	PSM	0	40	0	40	0	0	0	0	0.0%
14	Edmond Krasniqi	PSM	0	132	0	132	0	0	0	0	0.0%
15	Edmond Krasniqi	PSM	0	49	0	49	0	0	0	0	0.0%
16	Edmond Krasniqi	PSM	0	40	0	40	0	0	0	0	0.0%
17	Feriz Uroci****	PSM	0	17	0	17	0	0	0	0	0.0%
18	Kadri Krasniqi	PSM	0	44	0	44	0	0	0	0	0.0%
19	Feriz Mami	PSM	4	49	0	50	0	0	0	0	1.9%
20	Edmond Krasniqi****	PSM	0	130	0	130	0	0	0	0	0.0%
21	Edmond Krasniqi	PSM	0	12	4	16	0	0	0	0	0.0%
22	Edmond Krasniqi	PSM	0	49	0	49	0	0	0	0	0.0%
23	Edmond Krasniqi	PSM	0	20	0	40	0	0	0	0	0.0%
24	Alban Haxhi**	SVV	6	144	16	140	0	0	0	0	9.9%
25	Edmond Krasniqi	SVV	0	140	6	140	0	0	0	0	6.4%
26	Alban Haxhi	SVV	10	272	3	230	29	30	300	0	13.9%
27	Feriz Mami**	AAK	0	50	10	50	0	0	0	0	1.9%
28	Edmond Krasniqi	AAK	0	48	13	60	0	0	0	0	2.2%
29	Edmond Krasniqi	AAK	0	40	2	40	0	0	0	0	1.9%
30	Edmond Krasniqi	VAAAT	4	40	0	40	0	0	0	0	1.9%
31	Edmond Krasniqi	VAAAT	4	40	0	40	0	0	0	0	1.9%
32	Edmond Krasniqi	MSM	0	48	12	60	0	0	0	0	1.9%
33	Edmond Krasniqi	MSM	0	16	4	20	0	0	0	0	0.0%
34	Edmond Krasniqi	SDP	0	24	9	33	0	0	0	0	1.9%
35	Edmond Krasniqi	SDP	0	12	9	21	0	0	0	0	1.9%
36	Edmond Krasniqi	PS	0	16	0	16	0	0	0	0	0.0%
37	Edmond Krasniqi	PS	0	20	0	20	0	0	0	0	1.9%
38	Edmond Krasniqi	PS	0	12	0	12	0	0	0	0	0.0%
39	Edmond Krasniqi	PS	0	48	0	48	0	0	0	0	1.9%
40	Edmond Krasniqi	AKR	0	140	0	140	0	0	0	0	0.0%
41	Edmond Krasniqi	SLP	2	36	0	36	0	0	0	0	0.0%



► Konsolidimi i Grupit të Grave Asambleiste të Mamushës, dhjetor 2015



ARRITJET E PROJEKTIT

- Si rezultat i publikimit të Fletënotimit vjetor, është rritur dinamika e diskutimeve në Kuvendet komunale, është përmirësuar performanca e institucioneve në aspekt të ofrimit të qasjes në informata publike dhe bërjen publike të shpezimeve.
- KDI ka mobilizuar qytetarët, OJQ-të dhe mediat për të mbështetur iniciativën për kthimin e pronës publike tek qytetarët duke e transformuar atë në hapësirë të gjelbër rekreative dhe jo për t'ia dhënë në shfrytëzim një biznesi. Presioni publik ka bërë që kjo temë të futet në agjendë të Kuvendit Komunal
- Për herë të parë, me mbështetjen e KDI, Grupi i Grave Asambliste është involvuar në procesin zgjedhor të këshillave lokale duke e mbështetur dhe fuqizuar kështu gruan në vendim-marrje. Për herë të parë një grua është zgjedhur kryetare e këshillit lokal, ndërsa dy tjera anëtare të këshillave lokale. KDI poashtu ka qenë pjesë e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale në Rahovec dhe pjesë e komisionit shqyrtues për të dhënë në shfrytëzim pronën publike në Prizren.
- Dëgjimet publike që KDI i ka organizuar me qytetarë kanë rezultuar me përfshirje të ideve konkrete në projeksionet buxhetore të komunës për 2016. Si rrjedhojë, janë alokuar fonde për shumë projekte infrastrukturore, si për: a) rrugën, Pataqan i Poshtëm (Kodi buxhetor KB 43466), Celinë-Nagavc (KB 43474; b) varrezat në fshatin Pastasel (KB 43486) c) shkollën fillore në Apterushë (KB 40868), rrjedhën e lumit në Ratkoc (KB 43491), f) shtratin e lumit në Landovicë (KB 43491) g) rrugët në Krushë të Vogel (KB 40620), Vërmicë (KB 40655), Balincë (KB 88060), Shkozë (KB 43853) dhe Gornje Selo (KB 43368), j) qnëdrueshmërinë e klubit sportiv në Prizren me 200.000 euro, k) trotoret në fshatin Marali (KB 88060), l) kanalizimet në Pllaçicë dhe Mirushë (KB 89842, 89842).

Statistikat e aktiviteteve:

3 Publikime	4 Dëgjime publike (81 pjesëmarrës)
5 Konferenca për media	6 Tryeza (134 pjesëmarrës)
5 Komunikata për media	7 Punëtori (80 pjesëmarrës)
74 Mbledhje të monitoruara	1 Debat Televiziv
	20 Artikuj në Media

4.4. PËRKRAHJE PËR PROCESIN E REFORMËS SË ADMINISTRATËS PUBLIKE DUKE PËRMIRËSUAR MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN

Ky projekt ka për qëllim që t'i vë në pah mediat sociale si një instrument i cili duhet të përdoret nga qeveritë në rikrijimin marrëdhëniet e tyre me qytetarët dhe si pasojë të kontribuojë në krijimin e një hapësire në rritje për transparencë dhe demokraci më përfaqësuese dhe më pjesëmarrëse. Si pasojë e mungesës së fondeve të nevojshme dhe të vullnetit politik të ministrive të Qeverisë së Kosovës, projekti “e-qeverisje”, ka mbetur prapa. Shumë projekte që duhet të kenë filluar tashmë zbatimin dhe se do të kishin kontribuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, veçanërisht në shpenzimet publike, kanë qenë të lënë pas dore dhe nuk kanë përfunduar. Shembull i tillë është iniciativa e-prokurimit që duhet të shohin një zbatim të menjëhershëm dhe efikas dhe angazhimin serioz të

zyrtarëve publikë të përfshirë në projekt. Duke pasur këto ndër shumë elemente të tjera parasysh, KDI ka shfrytëzuar mediat sociale për promovimin e shumë aktiviteteve në kuadër të projekteve implementuese.

Në kuadër të fushëveprimit të këtij projekti, KDI, në bashkëpunim me një projekt të financuar nga BE menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë “Mbështetje për procesin e Reformës së Administratës Publike, duke përmirësuar menaxhimin e financave publike dhe Llogaridhënies në Kosovë” kanë prodhuar tre shembuj të përdorimit të tillë e mediave sociale. KDI ka përdorur faqen e saj në Facebook për të promovuar aktivitete të ndryshme.

Infografika që KDI ka përdorur ilustron se si shpenzimet e shënjestruara mund të sjellin vlerë për para, apo të kundërtën. Siç mund t'a shihni, përmes këtyre rasteve, KDI ka arritur që të theksojë rëndësinë e mediave sociale, përkatësisht Facebook-ut edhe si instrument për aktivitete të tilla, pasi që ky instrument ofron indikatorë të mire se sa pritet një informacion i caktuar nga publiku.

Statistikat e Projektit

3 Infografika



➤ Vendorsja e kamerave të sigurisë në Vushtri



➤ Shtrati i lumit në Shtime, para dhe pas intervenimit





ARRITJET E PROJEKTIT

- KDI ka arritur që të promovojë 3 raste suksesi në administrimin e mire të parasë përmes facebook-ut. Dy rastet e para kanë të bëjnë me projekte të suksesshme të komunave që ishin prioritare bashkë me qytetarët. Po ashtu, rasti i instalimit të 12 kamerave të sigurisë në qendër të komunës së Vushtrrisë ka pasur efektin e rritjes së sigurisë për bizneset dhe shtëpitë e vendosura në atë pjesë të qytetit. Sipas

Komandantit të Policisë së Kosovës në Vushtrri, vendosja e kamerave ka pasur dy efekte të mëdha në përmirësimin e sigurisë në qytet si ajo e parandalimit të krimit kur janë paraqitur elemente të dyshimta si dhe zbulimin e rasteve të krimeve dhe kundërvajtjeve të ndryshme. Shpenzimi i duhur i taksave të qytetarëve më së miri bëhet kur prioritetet vendosen së bashku me qytetarët siç është rasti në Vushtrri.



4.5. DEMOS - DEMOKRACIA LOKALE

KDI ka vazhduar të ofrojë ndihmë teknike dhe ekspertizë në mobilizimin e qytetarëve për krijimin e këshillave të fshatrave në 17 komunat partnere të organizatës zvicerane Helvetas.

KDI ka facilituar dhe lehtësuar tryeza me Kryesuesit e Këshillave të Fshatrave (KKF) dhe zyrtarë komunalë për të ndërtuar planet komunale si ato për: mobilitet, për menaxhim të mbeturinave dhe menaxhimin e hapësirave të lira publike. KDI ka asistuar KKF që të informojnë dhe sensibilizojnë qytetarët e lokaliteteve të tyre për rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në këto procese të hartimit të planeve. KKF dhe KDI kanë ftuar qytetarët të bëhen pjesë e takimeve publike në mënyrë që të fuqizohet elementi i gjithpërfshirjes në vendim-marrje dhe në mënyrë që qytetarët të krijojnë pronësi mbi këto plane, implementimi i të cilave do të ishte edhe më i lehtë edhe më i kapshëm.

Statistikat e Projektit

12 Tryeza

7 Takime publike

50 Takime me qytetarë



5. KDI NË INICIATIVA TË PËRBASHKËTA ME OSHC

Kriza dhe zhvillimet politike të 2015-tës, kishte vënë në urgjencë KDI-në, si organizatë monitoruese e punës së Kuvendit që të angazhohet dhe të koordinohet me akterë tjerë të shoqërisë civile për të bërë thirrje tek spektri politik për të dialoguar dhe për të gjetur rrugëdalje nga situata. Aktivitetet e spikatura përfshijnë Marshin Paqësor, Tryezën “Alternativat përmes Dialogut” dhe takimin me Presidenten Jahjaga.

Më 23 Tetor, KDI së bashku me OSHC, organizoi një Marsh Paqësor me moton **#GjejeniZgjidhjen #Dialog #JoDhune**

- Bëjmë thirrje që dhuna të mos jenë pjesë e veprimit politik si brenda ashtu jashtë institucioneve të Kosovës. Gjuha e dialogut politik është forma e vetme e zgjidhjes së problemeve politike.

- Mbështesim iniciativën e Presidentes Jahjaga për takim me liderët e subjekteve politike parlamentare, në funksion të tejkalimit të gjendjes së krijuar dhe inkurajojmë subjektet politike për gjetjen e zgjidhjeve konkrete për normalizimin e jetës parlamentare dhe institucionale në vend.
- Thirrja e seancave plenare pa ndryshim të qëndrimeve dhe rrethanave politike, nuk i shërben daljes nga situata e krijuar politike, përkundrazi ajo mund të ndikojë në përshkallëzimin e mëtutjeshëm të saj.



► Foto nga Marshi Paqësor i OSHC-ve, 23 tetor, 2015




► Foto nga tryeza: Alternativat përmes dialogut, 21 tetor 2015




► Foto nga takimi i OSHC-ve me Presidenten Jahjaga, 19 Tetor 2015




6. INFOGRAFIKAT




a Sistemet Zgjedhore për Legjislativ në vendet e Evropës Nuk ka sistem të përsosur zgjedhor që i përshtatet çdo situatë. Secili vend përshtat sistemin zgjedhor rrethaneve të veta të brendshme.



b Zgjedhja e Presidentit/Kreut të Shtetit në vendet e Evropës




c Pragu zgjedhor për subjektet politike në zgjedhjet parlamentare në Evropë




d Gratë në Parlament dhe Kuota Gjinore





e Pjesëmarrja në Zgjedhje



f Cikli Zgjedhor



7. STRUKTURA ORGANIZATIVE E KDI

Bordi i Drejtorëve

Bordi i KDI përbëhet nga pesë (5) aktivistë të shoqërisë civile. Kryesuese e bordit është Violeta Zeka e cila është ndër themelueset e KDI, ndërkohë që katër anëtarët tjerë janë: Enver Robelli (kolumnist), Jehona Lushaku (Ligjëruese në Universitet, Shkenca Politike), Rreze Duli dhe Bashkim Gashi (përfaqësuese të organizatave të shoqërisë civile).

Stafi

Gjatë vitit 2015, KDI ka punësuar 25 staf me zyre në Prizren dhe Prishtinë, 48 % e të cilëve janë burra, ndërsa 52% janë gra. Pjesa dërmuese e stafit kanë përvojë të gjatë në pjesëmarrjen qytetare, qeverisjen lokale, zgjedhjet dhe aktivitetet kundër korrupsionit.

PROFILI DHE EKSPERTIZA E ANËTARËVE TË STAFIT, 2015

ISMET KRYEZIU, Drejtor Ekzekutiv

Ka përvojë të gjatë në shoqëri civile që nga viti 2000 përfshirë në aktivitetet të organizimit të komunitetit, qeverisjen lokale dhe zgjedhjet, monitorimin e institucioneve publike, barazi gjinore, etj. Ai aktualisht udhëheq OSHC-në që është në krye të Koalicionit të Shoqërisë Civile për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, Demokracia në Veprim.

DRITON SELMANAJ, Menaxher i Projektit

Dritoni është analist i politikave, dhe njohës i çështjeve që ndërlidhen me monitorimin dhe raportimin mbi punën e institucioneve ekzekutive dhe ligjvënëse, si në nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal. Me ekspertizën e tij, ai ka kontribuar në KDI për 8 vjet në përgatitjen e hulumtimeve dhe analizave mbi politikat publike.

JETMIR BAKIJA, Menaxher i Projektit

Jetmiri është aktivist i shoqërisë civile, që ka punuar në projekte të ndryshme të organizatave vendore dhe ndërkombëtare që kanë pasur në fokus pjesëmarrjen qytetare në proceset vendimarrëse. Në 2015 ai ka menaxhuar projektin për përkrahjen e Kuvendit me hulumtime parlamentare nga institucionet hulumtuese që kanë për synim mbështetjen e OSHC-ve për avokim në bërjen e politikave.

NAIM CANHANAJ, Menaxher i Projektit

Naimi ka përvojë solide në qeverisje lokale për rajonin e Prizrenit. Që nga viti 2010 ka ndihmuar sekretariatit e koalicionit të OSHCve Demokracia në Veprim. Ai ka shërbyer si pikë ndërlidhëse në mes të shoqërisë civile dhe zyrtarëve publik në shumë komuna, duke i ndihmuar KDI-së që të nxisë pjesëmarrjen qytetare në bërjen e politikave.

ALBERT KRASNIQI, Menaxher i Projektit

Alberti ka përvojë të gjatë dhe të vlefshme në shoqëri civile me projektet që lidhen me demokratizimin e brendshëm subjekteve politike, sistemet zgjedhore dhe Para se t'i bashkohet KDI-së, Alberti ka punuar në Institutin KIPRED. Ai është përgjegjës për menaxhimin e projektit me Parlamentin e Kosovës dhe platformës Vota.ime.

ARBEN HOXHA, Hulumtues

Arbeni është duke punuar në programin për qeverisje lokale në rajonin e Prizrenit. I është bashkangjitur KDI në Shkurt të vitit 2012, dhe është përgjegjës për monitorimin e punës së Kuvendeve Komunale dhe komiteteve, si dhe mbështetjen në hartimin analizave mbi politikat publike.

VJOLLCA VOGËL, Menaxhere e Financave

Vjollca ka mbi 16 vjet përvojë në menaxhimin e financave, dhe është përgjegjëse për një portfolio financiare të shumëllojshëm, duke menaxhuar njëkohësisht disa projekte, që së bashku e tejkalojnë qarkullimin prej 500.000 Euro.

ISUF ZEJNA, Hulamtues

Isufi është i specializuar në monitorimin e prokurimit publik dhe ka trajnuar OSHC-të vendore për mekanizmat e raportimit. Sferat tjera të ekspertizës përfshijnë kundër korrupsionin, analizat mbi politikat publike, dhe menaxhimin e projekteve në përgjithësi. Në KDI ka shërbyer mbi 7 vite.

LEONORA CIKAJ, Asistente e Financave

Duke qenë e angazhuar në KDI që nga vitit 2008, Leonora ka përvojë në administratë dhe financa. Ajo asiston në menaxhimin e financave të projekteve dhe ruajtjen e regjistrave të kontabilitetit.

EDITA MUSTAFA-SALIHI, Koorditore e programeve

Duke qenë e angazhuar për shumë vite me NDI dhe International Medical Corps e OSBE, Edita ka përvojë të gjatë me programet e shoqërisë civile dhe përvojë ndërkombëtare në përkrahje të shërbimeve për ushtrisë amerikane, sektori I prokurimit dhe furnizimeve. Nga përvoja me menaxhimin e projekteve në sferën e qeverisjes lokale dhe zgjedhjeve, ajo ka shkathtësi të forta të menaxhimit.

VISAR SUTAJ, Menaxher i Projektit

Visari është i angazhuar në shoqërinë civile për më shumë se 10 vite, si në Kosovë ashtu edhe jashtë vendit. Është trajnuar për organizim të komunitetit në SHBA, ka përvojë në sferën e zgjedhjeve, kundër korrupsionit dhe sundimit të ligjit, dhe në projekte të tjera të mbështetura nga USAID.

ARTAN CANHASI, Menaxher i Programit

Artani ka përvojë të gjatë me organizatat ndërkombëtare si OSBE, NDI dhe EULEX. Ai është përgjegjës për menaxhimin e programit "Transparenca dhe Anti-korrupsioni" për të zhvilluar hulumtimin, si dhe draftin e prezantimit të raportit mbi Sistemin Nacional të Integritetit (NIS).

QENDRESA MRASORI, Hulamtuese

Qendresa i është bashkangjitur KDI rishtazi, pas angazhimit si hulamtuese në Kuvendin e Kosovës. Ajo ka qenë e përfshirë në hulumtimet që ndërlidhen me çështjet e qeverisjes lokale dhe ka ndihmuar në avancimin e përpjekjeve të KDI në kuadër të këtij programi. Gjithashtu, Qendresa ka ndihmuar menaxhimin e projektit në vlerësimin e performancës së institucioneve lokale përmes indikatorëve dhe metodologjisë së zhvilluar brenda organizatës.

NITA TAFARSHIKU, Asistente e administratës dhe financave

Nita ka punuar për shumë vite në OSHC-të lokale dhe ka eksperiencë të gjatë në sferën e financave. Nita është përgjegjëse për procedimin e pagesave dhe mirëmbajtjen e dokumenteve financiare.

BORA DULI, Hulamtuese

Bora është studente e Fakultetit Juridik në Shkollën Evropiane të Drejtësisë dhe Qeverisjes. I është bashkangjitur KDI-së si pjesë e programit të praktikantëve dhe është angazhuar në programin e zgjedhjeve. Ajo ka qenë e përfshirë në futjen e të dhënave nga rezultatet e zgjedhjeve në data bazë dhe në identifikimin e parregullsive të zgjedhjeve në raportet e vëzhgimit të dërguara nga vëzhguesit e Demokracisë në Veprim. Në kohët e fundit, Bora është e angazhuar si hulamtuese (junior) pasi ka treguar punë të mirë dhe aftësi në zhvillimin e projekteve të organizatës.

KALTRINA AHMETI, Menaxhere e Projektit

Kaltrina vjen në KDI me një përvojë si hulamtuese në Kuvendin e Kosovë ku ka analizuar përputhshmërinë e legjislacionit kosovar me atë të BE-së. Më herët ajo kishte punuar si ndihmëse ligjore në një avokatit ku kishte asistuar avokatët në konsulta me klientë. Ajo ka magjistruar në SHBA në të Drejtën Ndërkombëtare Tregëtare.

DIANA METUSHI KRASNIQI, Hulamtuese

Diana ka një përvojë të gjatë ndërkombëtare në prokurim dhe menaxhim të kontratave multimilionëshe për shërbime të ushtrisë amerikane. Diana është njohëse e shkëlqyer e legjislacionit federal dhe evropian të prokurimit, ndërsa në KDI ka analizuar kontratat/tenderet e institucioneve publike dhe ka përpiluar raportet për publik.

FIONA MUSTAFA, Hulumtuese

Fiona i është bashkangjitur KDI-së fillimisht si asistente në projektin “Sistemi i Integritetit Kombëtar”, dhe me pas është angazhuar dhe në projekte të tjera të programit “Transparenca dhe Anti-Korrupsioni”, duke ofruar mbështetjen e saj në mbledhje të të dhënave për raporte hulumtuese, dhe aktivitete të tjera, si p.sh në Dokumentar të Anti-Korrupsionit dhe në anëtarësimin e KDI në UNCAC. Fiona ka diplomuar në të drejtën europiane.

FESTINA KABASHI, Hulumtuese

Festina i është angazhuar me KDI në projektin “Përfshirja e qytetarëve për transparencë dhe llogaridhënie” në Prizren përmes së cilit monitorohen Kuvendet Komunale të regjionit të Prizrenit dhe aktivitete të prokurimit publik në Komunën e Suharekës dhe Prizrenit. Ajo gjithashtu ka qenë e përfshirë në aktivitete të cilat kanë synuar ta fuqizojnë rolin dhe ndikimin e gruas në vendimmarrje në nivel lokal.

FJOLLA UKA, Monitoruese

Para se të bëhej pjesë e ekipit të KDI-së, Fjolla ka qenë pjesë e NDI në Programin për Fuqizimin e Kuvendit, fillimisht si praktikante në Kuvendin e Kosovës dhe më pas është punësuar si Asistente Ligjore, ku ka mbështetur punën e Komisionit Parlamentar për Reformë Zgjedhore. Në KDI ajo është monitoruese e punës së Kuvendit të Kosovës në Programin për Kuvendin dhe bënë përditësimin e të dhënave në platformën Votalme.

MËRGIME KAJTAZI, Monitoruese

Mërgimja i është bashkangjitur ekipit të KDI-së për monitorim të punës së Kuvendit në korrik të vitit 2015. Aktivitetet e saja të përditshme përfshijnë monitorimin e mbledhjeve të komisioneve parlamentare dhe aktivitete të tyre në përgjithësi. Mërgimja është në prag të përfundimit të studimeve në Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës. Përvojat e saj të punës përfshijnë praktikën në NDI dhe organizatat tjera rinore në vend.

FLORENT SPAHIJA, Këshilltar Ligjor

Florenti së fundmi i është bashkëngjitur KDI në programin e saj “Transparenca dhe Anti-korrupsioni” pjesë e së cilës është edhe qendra për ndihme juridike të viktimave dhe denoncuesve të korrupsionit ALAC, ku ai është përgjegjës për trajtimin juridik të rasteve të paraqitura. Ai ka përvojë të gjatë në fushën e sundimit të ligjit dhe në hulumtime. Florenti ndihmon KDI-në edhe në çështjet e tjera juridike.

MAJLINDA KURTI, Koordinatore e projektit

Majlinda i është bashkëngjitur KDI-së me dëshirën për të kontribuar në sektorin e shoqërisë civile, me përvojat e saj në sektorin bankar dhe atë të telekomunikimit. Ajo është përgjegjëse për koordinimin e aktiviteteve të projektit për këshilla ligjore dhe avokim, projekt ky në kuadër të programit Anti-Korrupsion brenda KDI-së.

GENC JAHA, Asistent i Administratës dhe Finance

Genci është student i vitit të katërt dhe të fundit në Universitetin e Prishtinës, Fakultetin Juridik. Ai ka qenë pjesë e shumë trajnimeve të disa organizatave ku ka shkëmbyer dhe përfituar përvoja të ndryshme si me: NDI, YIHR, PEN, FDH. Genci i është bashkangjitur KDI në fillim si praktikant e pas disa muajve, ka filluar punën si asistent i Administratës dhe Finance poashtu edhe merr pjesë në monitorimin e komisioneve parlamentare dhe e ndihmon në Qendrën e Thirrjeve, ALAC.

MUSA BAJRAKTARI, Hulumtuës

Musa është bashkangjitur KDI-së si hulumtuës në projektin e monitorimit të prokurimit publik. Përvojat e tij paraprake lidhen me ofrimin e ekspertizës ligjore dhe konsulencës në prokurim. Musa ka magjistruar të drejtën ndërkombëtare publike dhe të drejtat e njeriut në Malajzi.



8. QEVERISJA E BRENDSHME E KDI

KDI në 2015 ka ndërmarrë një sërë aktiviteteve që lidhen me përmirësimin e qeverisjes dhe menaxhimit të brendshëm të organizatës.

Në qershor 2015, stafi i KDI ka organizuar një punëtori 2 ditore ku ka vetë-vlerësuar gjerësisht të gjitha aspektet menaxheriale, organizative dhe financiare të organizatës. Vetëvlerësimi është bërë sipas metodologjisë së USAID për partner implementues, Vlerësimi i kapaciteteve të organizatës (OCA) nga i cili janë nxjerrë përparësitë dhe mangësitë. KDI punon vazhdimisht t'i adresojë mangësitë e identifikuara.

Bazuar në Statutin e Organizatës, Rregulloren e Punës dhe Kodin Etik, menaxhmenti ka nxjerrë politikën e punësimit sekondar të punëmarrësve e cila specifikon konditat për angazhimet në punën sekondare.

Pas ndjekjes së serisë së trajnimeve nga organizata Peer Education Network, KDI ka rishikuar dokumentet e saj të brendshme për t'u siguruar që qeverisja e saj është e bazuar në barazi gjinore. Në konkurset e saj për punësim, KDI është e obliguar të citojë klauzolën e cila inkurajon aplikantët e cilësdo gjinie të nënpërfaqësuar në organizatë të aplikojnë për pozitën e shpallur, në mënyrë që të mirëmbahet ekuilibri gjinor.



9. DONATORËT

Gjatë vitit fiskal 2015 KDI është mbështetur kryesisht nga donatorët ndërkombëtarë. Donatorët kryesorë të KDI për vitin 2015 kanë qenë: USAID, Komisioni European përmes Transparency International, Ambasada e Britanisë së Madhe në Kosovë, The Olof Palme International Centre, IFES, Ambasada Gjermane në Kosovë, Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur – KFOS, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile KCSF, Helvetas Swiss Intercooperation, UNDP, NGO PEN dhe GFA Consulting Group.



10. PASQYRAT FINANCIARE

Pasqyrat financiare të KDI-së janë përpiluar nga menaxhmenti i KDI-së ndërsa janë audituar nga kompania e Auditimit K&M në Prizren. Në vijim janë pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin fiskal 2015.

KDI Instituti Demokratik i Kosovës
Raporti i Pozitës Financiare (Bilanci)
01 Janar - 31 Dhjetor 2015

Pëshkrimi	Note	2015	2014
MJETET (Asetet)			
MJETET QARKULLUESE		190,835.89	119,654.39
Keshi dhe Ekuivalentët		190,085.89	119,003.96
Llogaria Bankare	3	189,864.56	118,839.80
Arka	3	221.33	164.16
Llogaritë e arkëtueshme dhe kërkesat		750.00	650.43
Llogaritë e Arkëtueshme		-	-
Parapagimet dhe Avanset	4	750.00	650.43
MJETET JO QARKULLUESE		-	-
Objekti dhe ndërtesat		-	-
Asetet tjera		-	-
GJITHSEJ MJETET		190,835.89	119,654.39
EQUITETI DHE DETYRIMET			
EQUITETI		189,635.89	119,065.90
NET Pakësim/Rritje nga periudhat e kaluara		119,065.90	119,065.90
NET Pakësim/Rritje e periudhës		70,569.99	
Detyrimet Afatshkurtëra		1,200.00	588.49
Detyrimet afatshkurtëra	5	1,200.00	588.49
Huazimet dhe mjetet e huaja		-	-
GJITHSE DETYRIMET		1,200.00	588.49
GJITHSEJ EQUITETI DHE DETYRIMET		190,835.89	119,654.39

|||||

KDI Instituti Demokratik i Kosovës
Raporti i Performancës Financiare (Raporti i të Ardhurave)
01 Janar - 31 Dhjetor 2015

Pëshkrimi	Note	2015	2014
TË HYRAT			
Të hyrat nga donacionet(Grantet)		514,012.40	687,406.14
Donacionet	6	514,012.40	687,406.14
Grantet			
Të hyrat tjera		978.60	7,739.33
Të hyrat nga aktivitetet		-	
Të hyrat e jashtëzakonshme		-	
Të hyrat tjera	6	978.60	7,739.33
GJITHSEJ TË HYRAT		514,991.00	695,145.47
SHPENZIMET			
Shpenzimet Programore		330,183.17	436,623.82
Pagat	7	217,388.06	308,254.21
Shpenzimet e projektit		105,939.01	121,891.33
Shpenzimet direkte		6,856.11	6,478.28
Shpenzimet Administratë/Menaxhment		97,730.19	149,391.64
Pagat		54,674.64	54,134.51
Shpenzimet operacionale		43,055.55	95,257.13
Shpenzimet tjera		16,507.66	18,724.68
Shpenzimet tjera Indirekte			5,158.83
Admin & Zyre		16,507.66	13,565.85
GJITHSEJ SHPENZIMET		444,421.01	604,740.14
NET RRIJTJE/ZVOGLIM PËR PERIUDHËN		70,569.99	90,405.33

|||||

6. Të hyrat dhe Shpenzimet

Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve për vitin 2015:

Nr i projektit	Donatori	Gjendja fillestare	Të hyrat	Fondet e kthyer	Gjendja me 31.12.2015	Shpenzimet totale	Fondet e transferuara nga 2015 në 2016
5000	KDI	4,484.33	978.60		5,462.93	- 12,925.66	18,388.59
5001	OPIC	20.79	41,361.14		41,381.93	40,917.19	464.74
5002	TI-S/Auswärtiges Amt		22,852.00		22,852.00	21,227.55	1,624.45
5003	BTD	2,135.19			2,135.19	2,135.19	0.00
5004	KFOS - Transparenca	6,003.50	6,005.00		12,008.50	12,008.50	0.00
5005	KCSF		89,326.00		89,326.00	48,344.96	40,981.04
5006	UNDEF	4,266.22	-		4,266.22	4,205.19	61.03
5007	GFA Consulting Group		5,000.00		5,000.00	5,000.00	0.00
5008	IFES	5,659.58	14,252.78		19,912.36	19,912.36	0.00
5009	TI-S/Komisioni Evropian	26,994.76	12,674.00		39,668.76	52,550.95	-12,882.19
5010	British - Public procurement	-	31,804.16		31,804.16	31,804.16	0.00
5011	KFOS - Avokimi		13,510.00		13,510.00	10,774.82	2,735.18
5012	UNDP		24,152.00		24,152.00	5,468.03	18,683.97
5013	USAID - Hulumtime Parlamentare	21,182.94	138,141.92		159,324.86	82,224.81	77,100.05
5014	USAID - Zgjedhje	53,006.24			53,006.24	31,086.67	21,919.57
5015	PEN		2,047.89		2,047.89	920.96	1,126.93
5016	KFOS - 2016	-	19,434.00		19,434.00	1.50	19,432.50
5017	British Embassy	(4,687.68)	19,891.51		15,203.83	15,203.83	0.00
5019	Helvetas		73,560.00		73,560.00	73,560.00	0.00
TOTAL		119,065.88	514,991.00	0.00	634,056.88	444,421.01	189,635.86

7. Shpenzimet

Shpenzimet për periudhën 01 Janar - 31 Dhjetor janë si në vijim:

Shpenzimet	2015	2014
Shpenzimet programore	330,183.17	436,623.82
Pagat	217,388.06	308,254.21
Shpenzimet për programet	105,939.01	121,891.33
Shpenzimet e drejtpërdrejta	6,856.11	6,478.28
Shpenzimet e menaxhmentit/administrimit	97,730.19	149,391.64
Pagat	54,674.64	54,134.51
Shpenzimet operacionale	43,055.55	95,257.13
Shpenzimet tjera	16,507.66	18,724.68
Shpenzimet e tjera	0.00	5,158.35
Admin & Zyre	16,507.66	13,565.85
Shpenzimet e përgjithshme	444,421.01	604,740.14

**FALEMNDERIT QË
UDHËTUAT ME NË.
SHIHEMI NË 2016!**

